# ГЛАСИЛО
# GAZETË

Март - Мај 2024
Mars - Maj 2024



## ЗЕЛС

ЗАЕДНИЦА НА ЕДИНИЦИТЕ НА ЛОКАЛНАТА САМОУПРАВА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

## BNJVL

BASHKËSIA E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



Почитувани,

Активностите на ЗЕЛС, во периодот март - мај 2024 година, продолжија со позабавено темпо поради спроведувањето на претседателските и на парламентарните избори во државата. Беше реализирана и средба на високи претставници на ЗЕЛС и Државната изборна комисија, со цел општините да ѝ излезат во пресрет и да обезбедат техничка и логистичка поддршка на ДИК, онаму каде што е потребно, за обезбедување непречено реализирање на изборниот процес.

Од особена важност за општините е што, во овој период, барањето на ЗЕЛС, доставено до Министерството за транспорт и врски пред речиси една година, а поврзано со прашањето за регулирање, конфискација и реупотреба на бесправно изградените објекти, доби правна основа во членот 66 од новиот Закон за управување со конфискуван имот, имотна корист, одземени предмети во кривична и прекршочна постапка, што го донесе Собранието на Република Северна Македонија на 19 март 2024 година. Со тоа, сите единици на локалната самоуправа имаат можност, по спроведувањето на одредени правни постапки, ваквите објекти да ги искористат за потребите на граѓаните наместо тие со години да ја нарушуваат естетиката на просторот или за нивно рушење општините да трошат огромни финансиски средства.

Активности поврзани со јакнење на капацитетите на општините од областа на социјалната заштита и активности за продлабочување на процесот на децентрализација во оваа област, ЗЕЛС реализираше и во овие три месеца. Исто така, за општините спроведе активности поврзани со родовата еднаквост. Во рамките на проектот „Зајакнување на општинските совети - Фаза 2“, во организација на УНДП и во партнерство со ЗЕЛС, општинските советници, членови на трите тематски работни групи: за родова еднаквост; за односи меѓу заедниците и за младински политики на локално ниво, имаа можност да дискутираат за справување со дезинформациите, говорот на омраза и дигиталното родово базирано насилство на локално ниво.

Во мај, ЗЕЛС го започна процесот на реакредитација за улогата на техничкиот секретаријат за спроведување на меѓународната програма БФЦ СЕЕ во нашата земја. Во овој период, во просториите на ЗЕЛС дојде и трочлена делегација од САЛАР Интернационал, организација основана од Шведската асоцијација на локални и регионални власти (САЛАР). Целта на посетата беше проширување на соработката меѓу двете асоцијации, поконкретно, на ЗЕЛС и беше понудена можност за поддршка во зајакнувањето на работата на нејзините тела и органи, преку пренесување на добри искуства.

Позитивна вест за општините е и тоа што до 10 јуни 2024 година, во рамките на Фондот за техничка документација, тие може да конкурираат за грант до 20 000 или до 50 000 долари за изработка на техничка документација за инфраструктурни проекти за намалување на загадувањето на воздухот. За овие и за другите активности може повеќе да прочитате на страниците од овој број на Гласило на ЗЕЛС.

Со почит,

Душица Перишиќ,
извршен директор на ЗЕЛС

Të nderuar,

Aktivitetet e BNJVL-së, në periudhën mars - maj 2024, vazhduan me ritëm më të ngadaltë për shkak të realizimit të zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare në vend. U mbajt edhe takim i përfaqësuesve të lartë të BNJVL-së dhe Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, me qëllim që komunat t'i dalin në ndihmë dhe t'i sigurojnë mbështetje teknike dhe logjistike KSHZ-së, aty ku është e nevojshme, për të siguruar mbarëvajtjen e pandërprerë të procesit zgjedhor.

Për komunat është me rëndësi të veçantë që në këtë periudhë, kërkesa e BNJVL-së, e dërguar në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve para gati një viti, e lidhur me çështjen e rregullimit, konfiskimit dhe ripërdorimit të objekteve të ndërtuara në mënyrë të paligjshme, ka marrë bazë ligjore në nenin 66 të Ligjit të ri për administrimin e pronës së konfiskuar, përfitimit pronësor, sendeve të sekuestruara në procedurë penale dhe kundërvajtëse, i cili është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut më 19 mars 2024. Me këtë, të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale kanë mundësi që pas zbatimit të procedurave të caktuara ligjore t'i shfrytëzojnë objektet e këtilla për nevojat e qytetarëve në vend që ato me vite të tëra të prishin estetikën e hapësirës apo për rrëzimin e tyre komunat të shpenzojnë mjetet shumë të mëdha financiare.

BNJVL-ja realizoi aktivitete lidhur me forcimin e kapaciteteve të komunave në sferën e mbrojtjes sociale dhe aktivitete për thellimin e procesit të decentralizimit në këtë sferë edhe në këta tre muaj. Gjithashtu ka realizuar aktivitete të lidhura me barazinë gjinore për komunat. Në kuadër të projektit "Forcimi i këshillave komunale - Faza 2", në organizim të UNDP-së dhe në partneritet me BNJVL-në, këshilltarët komunalë, anëtarë të tri grupeve tematike punuese: për barazi gjinore, për marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve dhe politikat rinore në nivel lokal, patën mundësi të diskutojnë për ballafaqimin me dezinformatat, gjuhën e urrejtjes dhe dhunën e bazuar digjitale gjinore në nivel lokal.

Në muajin maj, BNJVL-ja filloi procesin e riakreditimit për rolin e sekretariatit teknik për zbatimin e programit ndërkombëtar BFC SEE në vendin tonë. Në këtë periudhë, në hapësirat e BNJVL-së erdhi një delegacion tre anëtarësh nga SALAR International, organizatë e themeluar nga Asociacioni Suedez i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale (SALAR). Qëllimi i vizitës ishte zgjerimi i bashkëpunimit ndërmjet dy asociacioneve, më konkretisht, BNJVL-së iu ofrua mundësia për mbështetje në forcimin e punës së trupave dhe organeve të saj, përmes bartjes së përvojave të mira.

Lajm pozitiv për komunat është se deri më 10 qershor 2024, në kuadër të Fondit të Dokumentacionit Teknik, ato mund të aplikojnë për grant deri në 20 mijë ose deri në 50 mijë dollarë për përgatitjen e dokumentacionit teknik për projekte infrastrukturore për reduktimin e ndotjes së ajrit. Më shumë për këto dhe aktivitete të tjera mund të lexoni në faqet e këtij numri të Gazetës së BNJVL-së.

Me respekt,

Dushica Perishiq,
drejtor ekzekutiv i BNJVL-së


**ЗАЕДНИЦА НА ЕДИНИЦИТЕ НА ЛОКАЛНАТА САМОУПРАВА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА**

тел. +389 (0) 2 30 99 033, факс: +389 (0) 2 30 61 994
ул. Копенхагенска бр. 5, п.фах 32,
1000 Скопје, Република Северна Македонија

**Извршен директор на ЗЕЛС:**
Душица Перишиќ
**Заменик извршен директор на ЗЕЛС:**
Ардита Дема-Мехмети
**Подготвила:**
Весна Арсовска-Динковска
**Превод:** Славе Чорбев
**Лекторирал:** Валентина Великова
**Дизајн и подготовка и печатење:** Европа 92

**BASHKËSIA E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**

tel. +389 (0) 2 30 99 033, faks: +389 (0)2 30 61 994
rr. „ Kopenhagenska" nr. 5, F.P. 32,
1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

**Drejtor ekzekutiv i BNJVL-së:**
Dushica Perishiq
**Zëvendes drejtor ekzekutiv i BNJVL-së:**
Ardita Dema - Mehmeti
**Përgatiti:**
Vesna Arsovska - Dinkovska
**Përkthim:** Sllave Çorbev
**Lektoron:** Valentina Velikova
**Dizajnim dhe përgatitje shtyp:** Evropa 92

## „ПРЕТСТАВУВАЊЕ НА РЕФОРМСКИ КОНЦЕПТИ ОД РЕГИОНОТ НА CORE ПАРТНЕРСТВОТО“ -ТЕМА НА ТРКАЛЕЗНАТА МАСА ОРГАНИЗИРАНА ВО ЗЕЛС

„Претставување на реформски концепти од регионот на CORE партнерството“ беше темата на тркалезната маса што ја организираше ЗЕЛС, на 6 март, 2024 година во просториите на административната зграда на Заедницата. Тркалезната маса беше организирана во рамките на Партнерството за конкурентен регион (CORE), поддржано од Германската развојна агенција соработка спроведено од ГИЗ, каде ЗЕЛС е партнер и акредитиран носител за сертификација на општини со поволно деловно опкружување согласно меѓународната BFC SEE програма за сертификација на градови и општини во Југоисточна Европа. ЗЕЛС ги разгледа добрите примери понудени во брошурата што е изработена во рамките на CORE и издвои три концепти за дискусија. Првиот беше добра практика од Албанија, а се однесува на „Регистрација на данок и административни услуги“. Втора беше практиката од Република Српска, Босна и Херцеговина а се однесуваше на „Воспоставување систем на транспарентност и заштита на даночни обврзници“ и третата се однесуваше на ,,Реформа за развојно планирање“ што се применува во Федерација Босна и Херцеговина. На тркалезната маса учествуваа претставници од општините, од Министерство за финансии и МИОА, како и од релевантни домашни и странски институции. За презентирање на добрите практики се користеше видео –врска со експертите од другите земји, а во ЗЕЛС дојдоа претставници од НАЛЕД кои дадоа директен придонес на овој настан. Тие ги презентираа реформите, нивното воведување и влијание што го имале во нивните држави.

BFC SEE програмата обезбедува за општините јасни насоки за унапредување на своите перформанси, ниво

## “PREZANTIMI I KONCEPTEVE REFORMUESE NGA RAJONI I PARTNERITETIT CORE” - TEMË E TRYEZËS SË RRUMBULLAKËT TË ORGANIZUAR NË BNJVL

“Prezantimi i koncepteve reformuese nga rajoni i partneritetit CORE” ishte tema e tryezës së rrumbullakët të cilën e organizoi BNJVL-ja më 6 mars 2024, në hapësirat e ndërtesës administrative të Bashkësisë. Tryeza e rrumbullakët u organizua në kuadër të Partneritetit për Rajon Konkurrues (CORE), të mbështetur nga Agjencia Gjermane Zhvillimore për Bashkëpunim, të zbatuar nga GIZ-i, ku BNJVL-ja është partner dhe bartës i akredituar për certifikimin e komunave me mjedis të favorshëm afarist konform programit ndërkombëtar BFC SEE për certifikimin e qyteteve dhe komunave në Evropën Juglindore. BNJVL-ja shqyrtoi shembujt e mirë të ofruar në broshurën e përgatitur në kuadër të Partneritetit për Rajon Konkurrues (CORE) dhe veçoi tri koncepte për diskutim. Koncepti i parë ishte shembulli nga Shqipëria dhe i referohet “Regjistrimit të tatimit dhe shërbimeve administrative”. Koncepti i dytë ishte praktika nga Republika Sërpska, Bosnja dhe Hercegovina dhe kishte të bënte me “Krijimin e një sistemi të transparencës dhe mbrojtjes së taksapaguesve” dhe shembulli tretë kishte të bënte me “Reformën e planifikimit zhvillimor” që zbatohet në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës. Në tryezën e rrumbullakët morën pjesë përfaqësues nga komunat, Ministria e Financave dhe MSHIA-ja, si dhe nga institucionet relevante vendase dhe të huaja. Për prezantimin e praktikave të mira u përdor video-lidhja me ekspertë nga shtetet e tjera, ndërsa në BNJVL erdhën përfaqësues të NALED-it, të cilët dhanë një kontribut të drejtpërdrejtë në këtë ngjarje. Ata prezantuan reformat, aplikimin dhe ndikimin e tyre që kanë pasur në vendet e tyre.

Programi BFC SEE siguron udhëzime të qarta për avancimin e performancave të komunave, nivelin e







на квалитет и ефикасност на услуги кон приватниот сектор, како и конкурентност на локалното стопанство на регионално и меѓународно ниво. За стопанството и инвеститорите кои сакаат да ги пренесат или прошират своите дејности, BFC SEE обезбедува стабилно и предвидливо деловно опкружување и помага во идентификација на општини кои нудат најдобри услови за вложувања и имаат најголем потенцијал за развој во Југоисточна Европа. BFC SEE програмата претставува јасен сигнал кои општини имаат потенцијал за локален економски развој и кои од нив би требало натаму да се поттикнуваат во создавање подобар деловен амбиент. Партнерството за конкурентен регион (CORE), покрај ЗЕЛС, вклучува повеќе од 20 институции од Хрватска, Босна и Херцеговина, Црна Гора, Србија, Албанија и Косово.

cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve ndaj sektorit privat, si dhe konkurrencën e bizneseve lokale në nivel rajonal dhe ndërkombëtar. Për bizneset dhe investitorët që duan të bartin ose zgjerojnë aktivitetet e tyre, BFC SEE siguron një mjedis të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm biznesi dhe ndihmon për identifikimin e komunave të cilat ofrojnë kushtet më të mira për investime dhe kanë potencialin më të madh për zhvillim në Evropën Juglindore. Programi BFC SEE paraqet një sinjal të qartë për atë se cilat komuna kanë potencial për zhvillim ekonomik lokal dhe cilat prej tyre do të duhej të inkurajoheshin më tej në krijimin e një mjedisi më të mirë biznesi. Partneriteti për Rajon Konkurrues (CORE), përveç BNJVL-së, përfshin më shumë se 20 institucione nga Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Serbia, Shqipëria dhe Kosova.

## ДЕСЕТ ОПШТИНИ СЕ ПРИЈАВИЈА НА ПОВИКОТ НА ЗЕЛС ЗА УЧЕСТВО ВО КЛАСТЕР ЗА УЧЕЊЕ ЗА ИСПОРАКА НА СОЦИЈАЛНИ УСЛУГИ БАЗИРАНИ НА ПОТРЕБИТЕ НА ЗАЕДНИЦАТА

Арачиново, Валандово, Делчево, Кочани, Куманово, Новаци, Прилеп, Свети Николе и Тетово се општините што се пријавија на јавниот повик за изразување на интерес за учество во кластер за учење за испорака на социјални услуги базирани на потребите на заедницата (развојот на концептот за формирање дневни центри за реинтеграција и рехабилитација и на мобилни теренски тимови за испорака на социјални услуги) што го објави ЗЕЛС на 20 март, оваа година. Секоја општина пријави по еден претставник од општинската администрација, одговорен за социјалната политика и услуги и еден претставник од давателот на социјални услуги во општината кои во рамките на кластерот ќе ги надградуваат своите капацитети во градење локални политики и спроведување социјални услуги базирани на потребите на заедницата. За потребите на овие активности, по објавен јавен повик, ангажиран е и претставник од областа на социјалната интеграција. Повикот се спроведува во рамките на проектот „Регионална соработка за подобри социјални услуги на локално ниво“,

## DHJETË KOMUNA APLIKUAN PËR THIRRJEN E BNJVL-SË PËR TË MARRË PJESË NË KLASTERIN E MËSIMIT PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE SOCIALE TË BAZUARA NË NEVOJAT E KOMUNITETIT

Haraçina, Vallandova, Dellçeva, Koçani, Kumanova, Novaci, Prilepi, Sveti Nikolla dhe Tetova janë komunat që aplikuan në thirrjen publike për shprehje interesi për të marrë pjesë në klasterin e mësimit për ofrimin e shërbimeve sociale të bazuara në nevojat e komunitetit. (Zhvillimi i konceptit për themelimin e qendrave ditore për riintegrim dhe rehabilitim dhe ekipeve mobile në terren për ofrimin e shërbimeve sociale) që e publikoi BNJVL-ja më 20 mars të këtij viti. Secila komunë ka paraqitur nga një përfaqësues nga administrata komunale, përgjegjës për politikat dhe shërbimet sociale dhe një përfaqësues nga ofruesi i shërbimeve sociale në komunë, të cilët, në kuadër të klasterit, do të përmirësojnë kapacitetet e tyre në sferën e ndërtimit të politikave lokale dhe zbatimit të shërbimeve sociale të bazuara në nevojat e komunitetit. Për nevojat e këtyre aktiviteteve, pas një thirrjeje publike të publikuar, është angazhuar edhe një ekspert nga sfera e integrimit social. Thirrja zbatohet në kuadër të projektit "Bashkëpunimi rajonal për shërbime më të mira sociale në nivel lokal", i cili





што е спроведен од НАЛАС во соработка со ГИЗ, во име на германското Министерство за економска соработка и развој (BMZ) и во партнерство од асоцијациите на единиците на локална самоуправа од земјите од Западен Балкан. Проектот истовремено ги зајакнува капацитетите на НАЛАС и на нејзините членки, асоцијациите од земјите од ЈИЕ, за да ја постават темата за социјална инклузија на повисоко ниво во нивните активности. Општините: Куманово и Делчево како пилот-општини во овој проект, добиваат финансиска поддршка за развој на услуги за реинтеграција и рехабилитација од 8 000 евра и своите искуства ќе ги пренесат на другите осум општини.

Кластерот за учење се дефинира како самостоен и соработнички метод за јакнење на капацитети што ги обединува практичарите и претставниците на различни сектори кои ја споделуваат истата работна средина и стекнуваат придобивки од разновидното знаење и искуства со цел да развијат применливи решенија и успешни пристапи што ќе ги применат во соодветната работна средина. Притоа тие ги гарантираат социјалните, економските и културните права на жените, децата, младите, лицата со попреченост, малцинства и ЛГБТИ-заедницата и нивното рамноправно учество во општеството.

Кластерот за учење вклучува: обука за услуги засновани во заедницата; три настани за размена на искуства; период на концептуализација и период на примена. Настаните за обука и размена на искуства од кластерот за учење ќе бидат организирани и спроведени од ЗЕЛС во период од мај 2024 година до април 2025 година. Придобивките за локалните самоуправи се повеќекратни, односно претставниците на локалните власти ќе имаат можност: да учат од добрите примери од експертот за примена на успешни социјални пристапи; да учат од искуствата и знаењето од колегите од општините; да подготват концепт за примена на социјалниот пристап на нивната територија; да го спроведуваат за првпат конкретниот социјален пристап и да обезбедат социјални услуги за ранливите групи; да споделат искуства од пречките со кои се соочувале при спроведувањето на социјалниот пристап; да обезбедат поддршка на другите членови на кластерот за учење и на тој начин да дејствуваат како колега- тренер дискутирајќи ги можните решенија.

zbatohet nga NALAS-i në bashkëpunim me GIZ, në emër të Ministrisë Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) dhe në partneritet me asociacionet e njësive të vetëqeverisjes lokale nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Projekti njëkohësisht forcon kapacitetet e NALAS-it dhe anëtarëve të tij, asociacionet nga vendet e EJL-së, për të vendosur temën e përfshirjes sociale në një nivel më të lartë në aktivitetet e tyre. Komunat: Kumanovë dhe Dellçevë si pilot komuna në këtë projekt marrin mbështetje financiare për zhvillimin e shërbimeve për riintegrim dhe rehabilitim në vlerë prej 8.000 Eurosh dhe përvojat e tyre do t'ua bartin tetë komunave të tjera.

Klasteri për mësim definohet si një metodë e pavarur dhe bashkëpunuese e ndërtimit të kapaciteteve që bashkon praktikuesit dhe përfaqësuesit e sektorëve të ndryshëm që ndajnë të njëjtin mjedis pune dhe marrin përfitime nga njohuritë dhe përvojat e ndryshme me qëllim që të zhvillojnë zgjidhje të zbatueshme dhe qasje të suksesshme që do t'i zbatojnë në mjedisin përkatës të punës. Duke vepruar kështu, ato garantojnë të drejtat sociale, ekonomike dhe kulturore të grave, fëmijëve, të rinjve, personave me aftësi të kufizuara, pakicave dhe komunitetit LGBT dhe pjesëmarrjen e tyre të barabartë në shoqëri.

Klasteri për mësim përfshin: trajnimin për shërbimet e bazuara në komunitet, tre ngjarje për shkëmbimin e përvojave, periudhën e konceptualizimit dhe periudhën e aplikimit. Ngjarjet për trajnimin dhe shkëmbimin e përvojave nga klasteri për mësim do të organizohen dhe zbatohen nga BNJVL-ja në periudhën nga maji 2024 deri në prill 2025. Përfitimet për vetëqeverisjet lokale janë të shumëfishta, gjegjësisht përfaqësuesit e autoriteteve lokale do të kenë mundësinë që: Të mësojnë nga praktikat e mira të ekspertit për zbatimin e qasjeve të suksesshme sociale; Të mësojnë nga përvojat dhe njohuritë e kolegëve nga komunat; Të përgatisin një koncept për zbatimin e qasjes sociale në territorin e tyre; Të zbatojë për herë të parë qasjen konkrete sociale dhe të sigurojnë shërbime sociale për grupet e cenueshme; Të ndajnë përvojat nga pengesat me të cilat janë ballafaquar gjatë zbatimit të qasjes sociale; Të sigurojnë mbështetje për anëtarët e tjerë të klasterit për mësim dhe në këtë mënyrë të veprojnë si një koleg – trajner duke diskutuar zgjidhjet e mundshme.

## БАРАЊЕТО НА ЗЕЛС ОПШТИНИТЕ ДА УПРАВУВААТ СО КОНФИСКУВАНИТЕ НЕЛЕГАЛНИ ГРАДБИ, СЕГА УТВРДЕНО И СО ЗАКОН

Барањето на ЗЕЛС доставено до Министерството за транспорт и врски, а поврзано со прашањето за регулирање, конфискација и ре- употреба на бесправно изградени објекти, доби правен основ во членот 66, од новиот Закон за управување со конфискуван имот, имотна корист, одземени предмети во кривична и прекршочна постапка, што го донесе Собранието на Република Северна Македонија на 19 март, 2024 година ( Службен весник на РСМ број 64/2024 ). Со тоа, сите единици на локална самоуправа имаат можност, по спроведување на одредени правни постапки, ваквите објекти да ги искористат за потребите на заедницата, односно во полза на своето население. Имено, во случаите кога со правосилна одлука е одземен или конфискуван недвижен имот кој е бесправно изграден (дивоградба), тогаш Агенцијата за управување со конфискуван имот врз основа на одлука на Владата го предава на единицата на локална самоуправа на нејзина натамошна надлежност. Единицата на локална самоуправа е должна да поведе постапка истиот имот да го легализира или да го урне во рок од шест месеци од приемот. Доколку имотот се легализира, единицата на локална самоуправа има право да стопанисува со недвижноста согласно со одлука на Владата. Стекнатата недвижност не смее да биде предмет на комерцијална продажба од страна на единиците на локална самоуправа, но може да биде отстапена на други органи на власта или на здруженија коишто се регистрирани за давање помош и заштита на социјално ранливите категории на граѓани. Впрочем, како што е утврдено и во членот 66, од Законот за управување со конфискуван имот, имотна корист, одземени предмети во кривична и прекршочна постапка гласи:

*„Во случаите кога со правосилна одлука е одземен или конфискуван недвижен имот кој е бесправно изграден (дивоградба), тогаш Агенцијата по предлог на Управниот одбор врз основа на одлука на Владата на Република Северна Македонија го предава на единицата на локална самоуправа на нејзина натамошна надлежност. Единицата на локална самоуправа е должна да поведе постапка истиот имот да го легализира или да го урне во рок од шест месеци од приемот. Доколку имотот се легализира, единицата на локална самоуправа има право да стопанисува со недвижноста согласно со одлука на Владата на Република Северна Македонија.*

*Стекнатата недвижност според ставот 1 од овој член не смее да биде предмет на комерцијална продажба од страна на единиците на локална самоуправа, но може да биде отстапена на другi органи на власта или на здруженија коишто се регистрирани за давање помош и заштита на социјално ранливите категории на граѓани на Република Северна Македонија.“*

Ова барање на ЗЕЛС всушност беше разгледувано и покренато пред речиси една година, односно на 16 седница на Управниот одбор на ЗЕЛС која се одржа на 4 април, 2023 година во општина Валандово, како поднесена

## KËRKESA E BNJVL-SË – KOMUNAT TË MENAXHOJNË ME OBJEKTET E KONFISKUARA QË JANË NDËRTUAR NË MËNYRË TË PALIGJSHME, TANI E PRANUAR EDHE ME LIGJ

Kërkesa e BNJVL-së, e dorëzuar në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve dhe e lidhur me çështjen e rregullimit, konfiskimit dhe ripërdorimit të objekteve të ndërtuara pa leje, ka marrë bazë ligjore në nenin 66 të Ligjit të ri për administrimin e pronës së konfiskuar, përfitimit pronësor, sendeve të sekuestruara në procedurë penale dhe kundërvajtëse, të cilin e miratoi Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut më 19 mars 2024 (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 64/2024). Me këtë, të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale kanë mundësi që pas zbatimit të procedurave të caktuara ligjore, objektet e këtilla t'i shfrytëzojnë për nevojat e komunitetit, përkatësisht në dobi të popullatës së tyre. Gjegjësisht, në rastet kur me vendim të formës së prerë është sekuestruar apo konfiskuar prona e paluajtshme që është ndërtuar në mënyrë të paligjshme (ndërtim pa leje), atëherë Agjencia për Administrim me Pronën e Konfiskuar, në bazë të vendimit të Qeverisë, ia dorëzon atë pronë njësisë së vetëqeverisjes lokale nën juridiksionin e saj të mëtejshëm. Njësia e vetëqeverisjes lokale është e detyruar të fillojë procedurën për legalizimin ose rrëzimin e së njëjtës pronë brenda gjashtë muajve nga marrja në dorëzim. Nëse prona legalizohet, njësia e vetëqeverisjes lokale ka të drejtë të administrojë me pronën në përputhje me vendimin e Qeverisë. Prona e paluajtshme e fituar nuk mund të jetë objekt i shitjes komerciale nga njësitë e vetëqeverisjes lokale, por mund t'u jepet në shërbim autoriteteve të tjera të pushtetit ose shoqatave të regjistruara për të ofruar ndihmë dhe mbrojtje për kategoritë e rrezikuara sociale të qytetarëve. Në fund të fundit, siç përcaktohet edhe në nenin 66 të Ligjit për administrimin e pronës së konfiskuar, përfitimit pronësor, sendeve të sekuestruara në procedurë penale dhe kundërvajtëse, ku thuhet:

*Në rastet kur me vendim të formës së prerë është sekuestruar ose konfiskuar prona e paluajtshme që është ndërtuar në mënyrë të paligjshme (ndërtim pa leje), atëherë Agjencia, me propozim të Bordit Drejtues në bazë të vendimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, ia dorëzon atë pronë njësisë së vetëqeverisjes lokale nën juridiksionin e saj të mëtejshëm. Njësia e vetëqeverisjes lokale është e detyruar të fillojë procedurën për legalizimin ose rrëzimin e së njëjtës pronë brenda gjashtë muajve nga marrja në dorëzim. Nëse prona legalizohet, njësia e vetëqeverisjes lokale ka të drejtë të administrojë me pronën në përputhje me vendimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.*

*Prona e paluajtshme e fituar sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk guxon të jetë objekt i shitjes komerciale nga ana e njësive të vetëqeverisjes lokale, por mund t'u jepet në shërbim autoriteteve të tjera të pushtetit ose shoqatave të regjistruara për të ofruar ndihmë dhe mbrojtje për kategoritë e rrezikuara sociale të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.*

Kjo kërkesë e BNJVL-së, në fakt, është shqyrtuar dhe iniciuar para gati një viti, gjegjësisht në seancën e 16-të të Bordit drejtues të BNJVL-së, e cila u mbajt më 4 prill 2023, në Komunën e Vallandovës, si iniciativë e parashtruar nga

иницијатива од Општина Центар. Во образложението беше посочено дека голем број општини се соочуваат со бројни нелегално изградени објекти кои по законски спроведената постапка за запирање на постапката за натамошна градба и спроведена правна процедура, со години ја нарушуваат естетиката на просторот и претставуваат дувло на бездомници, нехигиена и ширење на болести, а за нивно рушење општините треба да потроши огромни финансиски средства. Целта е овие бесправно изградени објекти кои не се предмет на легализација, а за кои е поведена кривична постапка против несовесните градители која завршила со правосилна пресуда, при конфискација на бесправниот објект да добијат употребна вредност. Исто така, беше посочено дека со тоа ќе се испрати и порака до сите што се дрзнуваат и понатаму да градат нелегално, да престанат со ваквите незаконски постапки. Управниот одбор ја прифати оваа иницијатива и истата беше доставена до сите единици на локална самоуправа кои безрезервно ја прифатија, по што ЗЕЛС го утврди барањето и го достави до надлежните органи на централната власт.

Komuna Qendër. Në sqarim u theksua se një numër i madh i komunave ballafaqohen me objekte të shumta të ndërtuara në mënyrë të paligjshme, të cilat pas procedurës së zbatuar me ligj për ndalimin e procedurës për ndërtime të mëtejshme dhe pas procedurës së zbatuar ligjore, për vite me radhë prishin estetikën e hapësirës dhe janë një vend johigjienik ku mblidhen të pastrehët dhe përhapen sëmundjet, ndërsa për rrëzimin e tyre komunat duhet të shpenzojnë mjete të mëdha financiare. Qëllimi është që këto objekte të ndërtuara pa leje, të cilat nuk janë objekt legalizimi dhe për të cilat ndaj ndërtuesve të pavetëdijshëm është nisur një procedurë penale dhe e cila ka përfunduar me vendim të formës së prerë, të fitojnë vlerë përdorimi gjatë konfiskimit të objektit të ndërtuar pa leje. Gjithashtu u theksua se me këtë do të dërgohet një porosi për të gjithë ata që guxojnë edhe më tej të ndërtojnë pa leje, të ndalojnë me veprimet e këtilla të paligjshme. Bordi drejtues e pranoi këtë iniciativë, e cila iu dorëzua të gjitha njësive të vetëqeverisjes lokale. Ata pa rezerva e pranuan atë dhe pastaj BNJVL-ja e përgatiti kërkesën dhe ia dorëzoi organeve kompetente të pushtetit qendror.

## ПУБЛИКУВАН „ГОДИШЕН ИЗВЕШТАЈ НА ЗЕЛС ЗА 2023 ГОДИНА“

ЗЕЛС подготви публикација „Годишен извештај на ЗЕЛС за 2023 година“ што претставува уште една форма на комуникација, преку која обезбедува поголема транспарентност во своето работење. Публикацијата е отпечатена на македонски и на албански јазик, а на англиски јазик е издадена во електронска форма и е поставена на веб страната на ЗЕЛС. Во Годишниот извештај се прикажани активностите и резултатите реализирани во текот на годината, како и приходите, расходите и Ревизорскиот извештај за 2023 година. Во оваа публикација е прикажано работењето на органите и телата на ЗЕЛС, детектирањето на предизвиците на локалната власт, лобирањето за нивно надминување, како и реализираните активности. Посочени се активностите на Управниот одбор на ЗЕЛС, на Генералното собрание, на Надзорниот одбор и на Комитетот на советите, како најзначајни органи во работењето на ЗЕЛС и главните прашања за кои тие дискутираа на своите седници. Прикажани се и резултатите од работењето на ЗЕЛС тренинг центарот чија задача е јакнење на капацитетите на општинската администрација како резултатите на ЗЕЛС единицата за поддршка на општините за проведување на електронските услуги. Од не помало значење е и континуираното информирање на своите членки -единиците на локалната самоуправа како и реализацијата на бројните проекти што ЗЕЛС ги реализира со домашни и странски институции. Овој извештај се усвојува од Генералното собрание на ЗЕЛС . Примерок од публикацијата добива секоја општина и истиот се поставува на веб- страницата на ЗЕЛС : www.zels.org.mk.




## PUBLIKOHET "RAPORTI VJETOR I BNJVL-SË PËR VITIN 2023"

BNJVL ka përgatitur publikimin "Raporti vjetor i BNJVL-së për vitin 2023" i cili paraqet edhe një formë të komunikimit, përmes të cilës sigurohet transparencë më e madhe në punë. Publikimi është i shtypur në gjuhën maqedonase dhe shqipe, ndërsa në gjuhën angleze është lëshuar në formë elektronike dhe është postuar në ueb faqen e BNJVL-së. Raporti Vjetor prezanton aktivitetet dhe rezultatet e realizuara gjatë vitit, si dhe të ardhurat, shpenzimet dhe raportin e auditimit për vitin 2023. Ky publikim tregon funksionimin e organeve dhe organeve të BNJVL-së, detektimin e sfidave të pushtetit lokal, lobimin për tejkalimin e tyre, si dhe aktivitetet e realizuara. Tregohen aktivitetet e Bordit Drejtues të BNJVL-së, Kuvendit Gjeneral, Bordit Mbikëqyrës dhe Komitetit të Këshillave, si organet më të rëndësishme në funksionimin e BNJVL-së dhe çështjet kryesore që diskutuan në seancat e tyre. Prezantohen edhe rezultatet nga funksionimi i qendrës për trajnime të BNJVL-së, detyra e së cilës është forcimi i kapaciteteve të administratës komunale, si dhe rezultatet e njësisë së BNJVL-së për përkrahje të komunave për realizimin e shërbimeve elektronike. Jo më pak rëndësi është edhe informimi i vazhdueshëm i anëtarëve të saj - njësitë e vetëqeverisjes lokale, si dhe realizimi i projekteve të shumta që BNJVL i realizon me institucionet vendore dhe të huaja. Ky raport është miratuar nga Kuvendi Gjeneral i BNJVL-së. Secila komunë merr një kopje të publikimit dhe i njejti është vendosur në ueb faqen e BNJVL-së: www.zels.org.mk.

## ЗЕЛС ПОСВЕТЕН НА ПРОДЛАБОЧУВАЊЕ НА ПРОЦЕСОТ НА ДЕЦЕНТРАЛИЗАЦИЈА И ВО ДЕЛОТ НА СОЦИЈАЛНАТА ЗАШТИТА

Предлог концептот на ЗЕЛС за застапување и лобирање во насока на продлабочување на процесот на децентрализација во областа на социјалните политики и социјални услуги, со фокус на децентрализација на Центрите за социјална работа, беше презентиран на работилница што се одржа од 3 до 5 април, 2024 година, во Нови Сад (Србија), во рамките на проектот „Регионална соработка за подобра социјална инклузија на локално ниво“. На работилницата беа претставени 12 концепти предложени од асоцијациите на локална самоуправа од земјите од Југоисточна Европа, членки на НАЛАС и од членовите на Работната група за социјална инклузија и миграција на НАЛАС што треба да претставуваат основа за утврдување на еден сублимиран документ.

Во предлогот на ЗЕЛС се утврдени конкретни предлози за активности што ќе се преземат во периодот од јуни 2024 до мај 2025 година во насока на лобирање за префрлање на Центрите на социјална заштита на локално ниво. Целта е обврските и надлежностите што ги имаат 30-те Центри за социјална работа во нашата земја да бидат управувани и фискално пренесени на општините, како и да се воведат нови социјални услуги за потребите на ранливите групи граѓани. Се планира наодите што ќе произлезат од Анализата на состојбата со процесот на децентрализација во областа на социјалната заштита во нашата земја да се презентираат пред централните институции. Исто така, со експертска поддршка ќе се спроведе и компаративна студија за состојбата со Центрите за социјална работа во земјите од регионот и врз основа на тоа ќе бидат утврдени препораки за понатамошно целисходно дејствување. Анализата и компаративната студија паралелно ќе се реализираат во период јуни- декември, 2024 година. Потоа ЗЕЛС ќе преземе низа активности за лобирање за децентрализирање на работата на центрите за социјална работа.

На работилницата беа изнесени и корисни примери за спроведување на целиот процес, меѓу кои можностите за поддршка од меѓународни и невладини организации што работат во областа на социјална заштита како и совети за подобро дефинирање на комуникациските канали и дополнување со ПР активности. Центрите за социјална работа во Хрватска се префрлени на локално ниво, а слично е и во Бугарија. Во Република Српска дел од надлежностите се децентрализирани, но фискалната зависност од централните и кантонските структури е голема. Напредок има во Србија, каде иако не е постигната целосна децентрализираност на социјалната работа, сепак голем дел од услуги ги покриваат општините.

Проектот “Регионална соработка за подобра социјална инклузија на локално ниво“ е финансиран од Германското министерство за економска соработка и развој, а спроведуван од Мрежата на асоцијации на Југоисточна Европа- НАЛАС и ГИЗ во кој е вклучена нашата земја, преку ЗЕЛС.

## BNJVL-JA ËSHTË PËRKUSHTUAR PËR THELLIMIN E PROCESIT TË DECENTRALIZIMIT EDHE NË SFERËN E MBROJTJES SOCIALE

Propozim koncepti i BNJVL-së për përfaqësim dhe lobim në drejtim të thellimit të procesit të decentralizimit në sferën e politikave dhe shërbimeve sociale me fokus në decentralizimin e qendrave për punë sociale, u prezantua në punëtorinë që u mbajt në periudhën nga 3 deri më 5 prill 2024 në Novi Sad (Serbi), në kuadër të projektit “Bashkëpunimi rajonal për përfshirje më të mirë sociale në nivel lokal”. Në punëtori u prezantuan 12 koncepte të propozuara nga asociacionet e vetëqeverisjes lokale të vendeve të Evropës Juglindore, anëtare të NALAS-it dhe anëtarët e Grupit të punës për përfshirje sociale dhe migrim të NALAS-it, të cilat duhet të jenë bazë për përcaktimin e një dokumenti të sublimuar.

Në propozimin e BNJVL-së janë përcaktuar propozime konkrete për aktivitetet që do të ndërmerren në periudhën nga qershori 2024 deri në maj 2025 në drejtim të lobimit për transferimin e qendrave për mbrojtje sociale në nivel lokal. Qëllimi është që detyrimet dhe kompetencat që i kanë 30 qendrat për punë sociale në vendin tonë të menaxhohen dhe të kalojnë fiskalisht te komunat, si dhe të aplikohen shërbime të reja sociale për nevojat e grupeve të cenueshme të qytetarëve. Planifikohet që gjetjet që do të dalin nga analiza e situatës me procesin e decentralizimit në sferën e mbrojtjes sociale në vendin tonë të prezantohen para institucioneve të pushtetit qendror. Gjithashtu, me mbështetjen e ekspertëve, do të zbatohet një studim krahasues i gjendjes së qendrave të punës sociale në vendet e rajonit dhe në bazë të kësaj do të përcaktohen rekomandimet për veprime të mëtejshme të përshtatshme. Analiza dhe studimi krahasues do të kryhen paralelisht në periudhën qershor - dhjetor 2024. Pastaj, BNJVL-ja do të ndërmarrë një sërë aktivitetesh për lobim për decentralizimin e punës së qendrave të punës sociale.

Në punëtori u prezantuan edhe shembuj të dobishëm për zbatimin e të gjithë procesit, duke përfshirë mundësitë për mbështetje nga organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare që punojnë në sferën e mbrojtjes sociale, si dhe këshilla për përcaktimin më të mirë të kanaleve të komunikimit dhe plotësimin e tyre me aktivitete të marrëdhënieve me opinionin. Qendrat për punë sociale në Kroaci janë transferuar në nivel lokal, ndërsa e ngjashme është edhe në Bullgari. Në Republikën Srpska, një pjesë e kompetencave janë të decentralizuara, por varësia fiskale nga strukturat qendrore dhe kantonale është e lartë. Progres ka në Serbi, ku edhe pse nuk është arritur decentralizimi i plotë i punës sociale, megjithatë një pjesë e madhe e shërbimeve ende mbulohen nga komunat.

Projekti “Bashkëpunimi rajonal për përfshirje më të mirë sociale në nivel lokal” është financuar nga Ministria Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim dhe është zbatuar nga Rrjeti i Asociacioneve të Evropës Juglindore – NALAS dhe GIZ, në të cilin është përfshirë edhe vendi ynë përmes BNJVL-së.

## ГРАДОНАЧАЛНИКОТ НА ОПШТИНА БЕРОВО ДОБИТНИК НА НАГРАДАТА „НАЈПРИЈАТЕЛСКИ ГРАДОНАЧАЛНИК НА РОМИТЕ ЗА 2024 ГОДИНА“

Градоначалникот на Општина Берово, Звонко Пекевски е добитник на Наградата „Најпријателски градоначалник на Ромите за 2024 година“. Врачувањето на наградите се случи на четвртото издание на церемонијата за доделување на оваа награда, од 9до 11 април, 2024 година во Брисел, по повод «Неделата на Ромите“. Церемонијата беше организирана од страна на «Roma Active Albania” и граѓанското општество, со финансиска поддршка од Европската унија во рамки на регионалниот инструмент за Претпристапна помош, насловен «Моќта на жените Ромки во промена на Западен Балкан и Турција». Домаќини беа ЕЕСК, Комитетот на регионите (КоР) и Европскиот парламент. Заедно со градоначалникот Пекевски, награди добија и по еден градоначалник од земјите од Западен Балкан: Босна и Херцеговина, Косово, Северна Македонија, Црна Гора, Србија и од Турција кои учествувале на конкурсот за оваанаграда. Со завршување на петгодишниот проект, вкупно биле доделени милион евра за општините во овие седум земји, каде локалните власти и институциите дејствувале и се залагале за поголема социјална инклузија на Ромите. Проектот е во согласност со Декларацијата од Познан за интеграција на Ромите, од јули 2019 година, каде се определени одредени цели во делот на едукација, вработување, домување, граѓанска документација, како и вклученост на Ромите во дигитална и зелена агенда, до моментот на пристапување на земјите во ЕУ. Наградите на годинешните добитници им беа врачени од страна на Валентина Суперти, директор за Западен Балкан во Генералниот директорат за соседство и преговори за проширување (DG NEAR). На настанот беа презентирани позитивните примери за вклучување на Ромите, истакнувајќи ја филозофијата на зајакнување, мобилизација и еднаков дијалог помеѓу локалните власти и ромските заедници, каде што општините и ромската заедница можат да се здружат и да се вклучат во дијалог на еднакво ниво.

Градоначалникот Пекевски ја доби оваа награда за неговиот особен придонес за инклузија на ромската заедница во целокупниот општествен живот во локалната самоуправа. Впрочем тој и на средбата што ја имаше со претставниците од ромската заедница, на „8 Април“-светскиот ден на Ромите кога им го честиташе празникот нагласи дека Општина Берово во согласност со европската идеја „обединети во различностите“ и понатаму продолжува во надминување на предизвиците и во залагањата за остварување на приоритетите на Ромската заедница.

## KRYETARI I KOMUNËS SË BEROVËS FITUES I ÇMIMIT “KRYETARI MË MIQËSOR I ROMËVE PËR VITIN 2024”

Kryetari i Komunës së Berovës, Zvonko Pekevski është fitues i çmimit “Kryetari më miqësor i Romëve për vitin 2024”. Ceremonia e ndarjes së çmimeve u zhvillua në edicionin e katërt të ceremonisë së ndarjes së këtij çmimi që u mbajt nga 9 deri më 11 prill 2024, në Bruksel, me rastin e “Javës së Romëve”. Ceremonia u organizua nga “Roma Active Albania” dhe organizatat e shoqërisë civile, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian në kuadër të instrumentit rajonal për asistencën paraqasëse, të titulluar “Fuqia e Grave Rome për ndryshim në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi”. Nikoqirë ishin EESK, Komiteti i Rajoneve (KOR) dhe Parlamenti Evropian. Së bashku me kryetarin Pekevski, çmime morën edhe nga një kryetar komune nga vendet e Ballkanit Perëndimor: Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia dhe Turqia, të cilat kanë marrë pjesë në konkursin për këtë çmim. Me përfundimin e projektit pesëvjeçar, gjithsej një milion euro iu ndanë komunave të këtyre shtatë vendeve, ku autoritetet lokale dhe institucionet kanë vepruar dhe janë zotuar për përfshirje më të madhe sociale të Romëve. Projekti është në përputhje me Deklaratën e Poznanit për integrimin e Romëve, nga korriku 2019, ku janë përcaktuar qëndrime të caktuara në fushën e edukimit, punësimit, strehimit, dokumentacionit civil, si dhe përfshirjes së Romëve në agjendën digjitale dhe të gjelbër, deri në momentin e anëtarësimit të vendeve në BE. Çmimet iu dorëzuan fituesve të këtij viti nga Valentina Superti, Drejtoreshë për Ballkanin Perëndimor në Drejtorinë e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit (DG NEAR). Në këtë ngjarje u prezantuan shembuj pozitivë për përfshirjen e Romëve, duke theksuar filozofinë e fuqizimit, mobilizimit dhe dialogut të barabartë ndërmjet autoriteteve lokale dhe komuniteteve rome, ku komunat dhe komuniteti rom mund të bashkohen dhe të përfshihen në dialog në nivel të barabartë.

Kryetari Pekevski e mori këtë çmim për kontributin e tij të veçantë në përfshirjen e komunitetit rom në jetën e përgjithshme shoqërore të vetëqeverisjes lokale. Në fund të fundit, në takimin që pati me përfaqësuesit e komunitetit rom, më 8 Prill – Ditën Botërore të Romëve, kur ua uroi festën, theksoi se Komuna e Berovës, në përputhje me idenë evropiane “Të bashkuar në diversitete”, vazhdon edhe më tej të tejkalojë sfidat dhe përpjekjet për të arritur prioritetet e komunitetit rom.



## ПРЕТСТАВНИЦИ ОД ЛОКАЛНАТА ВЛАСТ ОД ЗЕМЈИТЕ ОД ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА ИМАА СПЕЦИЈАЛНА СРЕДБА СО МЕТЈУ МОРИ, ГЕНЕРАЛЕН СЕКРЕТАР НА КОНГРЕСОТ ЗА ЛОКАЛНИ И РЕГИОНАЛНИ ВЛАСТИ НА СОВЕТОТ НА ЕВРОПА

Во периодот од 26 до 29 март, 2024 година, во Стразбур (Франција) Мрежата на асоцијации на локални самоуправи од земјите од Југоисточна Европа (НАЛАС) одржа повеќе состаноци на кои активно учествуваше и извршната директорка на ЗЕЛС, Душица Перишиќ. Овие активности беа реализирани во истиот период кога се одржуваше седница на Конгресот на локални и регионални власти на Советот на Европа на која се дискутираше за изнаоѓање на соодветни решенија за предизвиците со кои се соочуваат локалните самоуправи и за можностите за соработка за обезбедување на квалитетни услуги за граѓаните, инклузивност, одржливост и развој на инфраструктурата.

Од особено значење е што генералниот секретар на Конгресот за локални и регионални власти на Советот на Европа, Метју Мори имаше специјална средба со претставниците од локалната власт од земјите од Југоисточна Европа. Тој сакаше да слушне за предизвиците со кои се соочуваат регионите, градовите и општините од овие земји со цел зголемување на заложбите за поддршка од страна на Советот на Европа во изнаоѓањето на решенија за нивно надминување. Во разговорот како приоритет беше посочена можноста за обезбедување на поголем влијание од страна на Советот на Европа врз централните власти од овие земји, за обезбедување на поголем степен на функционална децентрализација на власта и финансиска самостојност на општините. Во Европската повелба за локалната самоуправа е утврдено дека за секоја префрлена надлежност на локално ниво, потребно е обезбедување на соодветно финансирање од страна на централната власт. Генералниот секретар даде ветување за сериозен пристап во разгледувањето на посочените теми од страна на Конгресот за локални и регионални власти на Советот на Европа.

Претставниците од асоцијациите на локални власти од земјите од Југоисточна Европа споделија и искуства и новитети за нивно подобро организирање и работење. Извршната директорка на асоцијацијата на локални власти на Грузија ( НАЛАГ) побара поддршка од поискусните колеги околу активностите за воспоставувањето на механизмите на успешно работење на една асоцијација. Дел од средбите беа посветени и на одредени технички прашања од работењето на НАЛАС, при што на состанокот на Комитетот на офицерите за врски, каде членуваат сите директори на асоцијациите на локални власти од земјите од Југоисточна Европа се дискутираше и за финансиските извештаи за работата на НАЛАС за претходната година, а беа разгледани и предлог буџетот и акцискиот план за 2024 година.

## PËRFAQËSUES TË PUSHTETIT LOKAL NGA VENDET E EVROPËS JUGLINDORE PATËN NJË TAKIM TË VEÇANTË ME METJU MORI, SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I KONGRESIT TË AUTORITETEVE LOKALE DHE RAJONALE TË KËSHILLIT TË EVROPËS

Në periudhën nga 26 deri më 29 mars 2024, në Strasburg (Francë), Rrjeti i Asociacioneve të Vetëqeverisjeve Lokale nga vendet e Evropës Juglindore (NALAS) mbajti më shumë takime në të cilat në mënyrë aktive mori pjesë edhe drejtoresha ekzekutive e BNJVL-së, Dusica Perishiq. Këto aktivitete u realizuan në të njëjtën periudhë kur mbahej seanca e Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës, në të cilën u diskutua për gjetjen e zgjidhjeve përkatëse për sfidat me të cilat ballafaqohen vetëqeverisjet lokale dhe për mundësitë e bashkëpunimit për sigurimin e shërbimeve cilësore për qytetarët, gjithëpërfshirjen, qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e infrastrukturës.

Është me rëndësi të veçantë që Sekretari i Përgjithshëm i Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës, Metju Mori pati një takim të veçantë me përfaqësuesit e autoriteteve lokale nga vendet e Evropës Juglindore. Ai donte të dëgjonte për sfidat me të cilat ballafaqohen rajonet, qytetet dhe komunat e këtyre vendeve me qëllim të rritjes së zotimeve për mbështetje nga ana e Këshillit të Evropës në gjetjen e zgjidhjeve për tejkalimin e tyre. Në bisedë, si prioritet u theksua mundësia për sigurimin e një ndikimi më të madh nga ana e Këshillit të Evropës mbi autoritetet qendrore të këtyre vendeve për të siguruar një shkallë më të madhe të decentralizimit funksional të pushtetit dhe pavarësisë financiare të komunave. Në Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale është përcaktuar se për çdo kompetencë të transferuar në nivel lokal nevojitet të sigurohet një financim adekuat nga ana e pushtetit qendror. Sekretari i Përgjithshëm dha premtim për një qasje serioze në shqyrtimin e temave të përmendura nga ana e Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës.

Përfaqësuesit e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale nga vendet e Evropës Juglindore shkëmbyen edhe përvoja dhe risi për organizimin dhe punimin e tyre më të mirë. Drejtoresha ekzekutive e Asociacioni i Autoriteteve Lokale të Gjeorgjisë (NALAG) kërkoi mbështetje nga kolegët më me përvojë lidhur me aktivitetet për vendosjen e mekanizmave të funksionimit të suksesshëm të një asociacioni. Një pjesë e takimeve iu kushtuan edhe çështjeve të caktuara teknike nga sfera e funksionimit të NALAS-it, kështu që në mbledhjen e Komitetit të Oficerëve për Lidhje, ku janë anëtarësuar të gjithë drejtorët e asociacioneve të autoriteteve lokale nga vendet e Evropës Juglindore, u diskutua edhe për raportet financiare për punën e NALAS-it për vitin paraprak, si dhe u shqyrtuan edhe propozim buxheti dhe plani aksionar për vitin 2024.






## СРЕДБА НА ПРЕТСТАВНИЦИ ОД ЗЕЛС И ОД ДРЖАВНА ИЗБОРНА КОМИСИЈА

Претседателот на ЗЕЛС, Орце Ѓорѓиевски на 4 април, 2024 година имаше средба со претседателот на Државна изборна комисија, Александар Даштевски и со членови на ова тело. На средбата, што беше иницирана на барање на ДИК, беше побарана од општините да обезбедат соодветна техничка и логистичка поддршка во претстојниот процес на спроведување на претседателски и парламентарни избори. Општините се законски обврзани да обезбедат простор за спроведувањето на гласањето, но беше посочено дека во одредени изборни пунктови потребна е поддршка и во обезбедување на одредени технички помагала (компјутери, печатачи и слично). Од ДИК информираа дека се утврдени локациите на изборните места кои во најголем дел се наоѓаат во простории на училиштата, училишни сали или градинките. Посочено беше дека се водела грижа во објектите да има обезбеден пристап за лицата со посебни потреби и беше побарано од општините да ја проверат техничката исправност и доколку е возможно да го подобрат нивниот квалитет со цел исполнување на правото на гласање, подеднакво за сите граѓани. Од посебно значење за ДИК претставуваше и обезбедувањето на соодветни простории каде еден ден пред изборите ќе се депонира потребниот изборен материјал. ДИК побараа општините да им излезат во пресрет на претставниците од ДИК во предизборните денови и најавија дека до ЗЕЛС и до локалните самоуправи ќе испрати и информација со поконкретни барања и насоки.

Претседателот на ЗЕЛС, Орце Ѓорѓиевски нагласи дека непречено спроведување на фер и демократски избори треба да биде императив на секој граѓанин и дека заедничка е обврската тие да се спроведат во најдобар ред. Тој се заблагодари на поканата од ДИК за взаемна соработка за непречено спроведување на подготовките за спроведување на изборите и посочи дека ЗЕЛС ќе се погрижи општините да излезат во пресрет на барањата на ДИК и навремено ќе бидат информирани за потребните активности што треба да се обезбедат од просторен, технички или организационен карактер.

## TAKIM I PËRFAQËSUESVE TË BNJVL-SË DHE KOMISIONIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE

Më 4 prill 2024, kryetari i BNJVL-së, Orce Gjorgjievski pati takim me kryetarin e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, Aleksandar Dashtevski dhe me anëtarë të këtij trupi. Në takim, i cili u iniciua me kërkesë të KSHZ-së, u kërkua nga komunat të sigurojnë një përkrahje përkatëse teknike dhe logjistike në procesin e zbatimit të zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare që vijon. Komunat janë të obliguara me ligj që të sigurojnë hapësirë për zbatimin e votimit, por u theksua se në vendvotime të caktuara nevojitet mbështetje edhe në sigurimin e mjeteve të caktuara teknike (kompjuterë, printerë, etj.). Nga KSHZ-ja informuan se janë përcaktuar lokacionet e vendvotimeve, shumica e të cilave janë të vendosura në hapësirat e shkollave, sallat e shkollave apo kopshtet e fëmijëve. Njëkohësisht u theksua se është marrë parasysh që në objektet të ketë qasje të siguruar për personat me nevoja të veçanta dhe u kërkua nga komunat të kontrollojnë funksionalitetin teknik dhe nëse është e mundur të përmirësojnë cilësinë e tyre me qëllim që të përmbushet e drejta e votës, në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetarët. Me rëndësi të veçantë për KSHZ-në është edhe sigurimi i hapësirave përkatëse ku do të depozitohet materiali i nevojshëm zgjedhor. Nga KSHZ-ja kërkuan që komunat t'u dalin në ndihmë përfaqësuesve të KSHZ-së në ditët para zgjedhjeve dhe paralajmëruan se do të dërgojnë informacione me kërkesa dhe udhëzime më konkrete deri te BNJVL-ja dhe vetëqeverisjet lokale.

Kryetari i BNJVL-së, Orce Gjorgjievski theksoi se zbatimi i pandërprerë i zgjedhjeve të drejta dhe demokratike duhet të jetë imperativ për çdo qytetar dhe se është obligim i përbashkët që ato të zbatohen në mënyrën sa më të mirë. Ai shprehu mirënjohje për ftesën e KSHZ-së për bashkëpunim të ndërsjellë për mbarëvajtjen e pandërprerë të përgatitjeve për zbatimin e zgjedhjeve dhe theksoi se BNJVL-ja do të përkujdeset që komunat t'u përgjigjen kërkesave të KSHZ-së dhe t'i informojnë me kohë për aktivitetet e nevojshme që duhet të sigurohen nga karakteri hapësinor, teknik ose organizativ.

# РАБОТНАТА СРЕДБА НА ПРЕТСТАВНИЦИ ОД ОПШТИНИТЕ ОД ПЕЛАГОНИСКИОТ И ОД ЈУГОЗАПАДНИОТ РЕГИОН - ПОСВЕТЕНА НА АКТИВНОСТИТЕ ЗА УПРАВУВАЊЕ СО ОТПАДОТ



„Оддрживи општински услуги во секторот отпад – Предизвици и патот понатаму“ беше темата на работната средба што се одржа на 2 април, 2024 година во просториите на Општина Новаци, во рамките на проектот „Оддрживо управување со отпадот на локално ниво“. На настанот беа презентирани резултатите од спроведените анализи, плановите за развој и креирањето на форум за соработка помеѓу општините во Пелагонискиот и во Југозападниот регион. Во проектот се вклучени шест пилот- општини од овие два региона: Битола, Прилеп, Новаци, Охрид, Кичево и Пласница. На присутните им се обрати домаќинот на настанот, градоначалникот на општина Новаци, Стевче Стевановски кој посочи дека управувањето со отпадот во нашата земја треба да биде приоритет и на локалната и на централната власт. Пред присутните се обратија и извршната директорка на ЗЕЛС Душица Перишиќ; раководителот за развојна соработка при Амбасадата на Шведска во нашата земја, Микаел Атерхог и Пеле Халберг, меѓународен експерт од САЛАР Интернационал. Присутните претставници од општините од двата плански региона развија сериозна дискусија околу реализацијата на изградбата на стандардизираната депонија и воспоставувањето на соодветен систем на управување со отпад, при што посочија и на бројни предизвици со кои се соочуваат. Беше нагласено дека овие активностите се речиси во почетна фаза и дека е потребно да се реализираат низа консултации меѓу општините, но и во соработка со централната власт, особено со Министерството за животна средина. Присутните нагласија дека е потребно да се редефинираат одредени позиции на локациите предвидени за претоварните станици за отпадот, но и да се обезбеди соодветен сообраќаен пат до локацијата предвидена за изградба на стандардизирана депонија.

На настанот беа презентирани досегашните резултати од Проектот. Посочено беше дека 14 општини усвоија локален акциски план за управување со отпад и дека е извршена проценка на капацитетите на општините за испорачување на интегрирани и инклузивни комунални услуги. Беа презентирани и конкретни мерки за јакнење на капацитетите на општинската администрации, инфраструктурата, финансиската стабилност и подигнување на јавната свест за одржливо управување со отпадот, а беа споделени и резултатите од извршената анализа на ризиците од пожари на депониите и мерки за нивна превенција. Особен интерес предизвикаа споделените практични примери од Шведска, за подобро управување со отпадот со меѓу- општинска соработка и зголемување на ефикасноста низ заедничко користење на достапните ресурси.

Проектот е иницирани од Шведската асоцијација на локални власти (САЛАР), имплементиран од SALAR International, а финансиран преку Шведската агенција за меѓународен развој СИДА. ЗЕЛС се вклучи во спроведување на овој проект во нашата земја заедно со Министерството за животна средина и просторно планирање и со Министерството за локална самоуправа.








# TAKIMI I PUNËS I PËRFAQËSUESVE TË KOMUNAVE TË RAJONIT TË PELLAGONISË DHE TË ATIJ JUGPERËNDIMOR IU KUSHTUA AKTIVITETEVE PËR MENAXHIM TË MBETURINAVE

"Shërbimet e qëndrueshme komunale në sektorin e mbeturinave – Sfidat dhe rruga më tej" ishte tema e takimit të punës që u mbajt më 02 prill 2024, në hapësirat e Komunës së Novacit, në kuadër të projektit "Menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave në nivel lokal". Në ngjarjen u prezantuan rezultatet e analizave të kryera, planet e zhvillimit dhe krijimit të një forumi për bashkëpunim ndërmjet komunave në rajonin e Pellagonisë dhe atë jugperëndimor. Në projekt janë përfshirë gjashtë pilot-komuna të këtyre dy rajoneve: Manastiri, Prilepi, Novaci, Ohri, Kërçova dhe Plasnica. Të pranishmëve iu drejtua nikoqiri i ngjarjes, kryetari i Komunës së Novacit, Stevçe Stevanovski, i cili theksoi se menaxhimi i mbeturinave në vendin tonë duhet të jetë prioritet edhe për pushtetin lokal edhe për pushtetin qendror. Para të pranishmëve folën edhe drejtoresha ekzekutive e BNJVL-së, Dusica Perishiq, udhëheqësi i bashkëpunimit të zhvillimit në Ambasadën e Suedisë në vendin tonë, Mikael Aterhog dhe Pele Halberg, ekspert ndërkombëtar nga SALAR International. Përfaqësuesit e pranishëm të komunave të të dyja rajoneve planifikuese patën një diskutim serioz për realizimin e ndërtimit të deponisë së standardizuar dhe krijimin e një sistemi përkatës të menaxhimit të mbetjeve, duke theksuar sfidat e shumta me të cilat po ballafaqohen. U theksua se këto aktivitete janë pothuajse në fazën fillestare dhe se është e nevojshme të realizohen një sërë konsultimesh mes komunave, por edhe bashkëpunim me pushtetin qendror, veçanërisht me Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor. Të pranishmit theksuan se duhet të ripërcaktohen pozicione të caktuara të lokacioneve të parapara për stacionet e transferimit të mbeturinave, por edhe të sigurohet një rrugë e përshtatshme trafiku deri në lokacionin e paraparë për ndërtimin e deponisë së standardizuar.

Në këtë ngjarje u prezantuan rezultatet e deritanishme të projektit. U theksua se 14 komuna kanë miratuar planet e tyre aksionare lokale për menaxhimin e mbeturinave dhe se është bërë një vlerësim i kapaciteteve të komunave për zbatimin e shërbimeve të integruara komunale dhe gjithëpërfshirëse. Gjithashtu u prezantuan masat konkrete për forcimin e kapaciteteve të administratës komunale, infrastrukturës, stabilitetit financiar dhe ngritjes së vetëdijes së opinionit për menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave, si dhe u shkëmbyen rezultatet e analizës së kryer së rreziqeve nga zjarret në deponi dhe masat për parandalimin e tyre. Një interes të veçantë shkaktuan shembujt e shkëmbyer praktikë nga Suedia për menaxhim më të mirë të mbeturinave përmes bashkëpunimit ndërkomunal dhe rritjen e efikasitetit përmes përdorimit të përbashkët të resurseve që janë në dispozicion.

Projekti është iniciuar nga Asociacioni Suedez i Autoriteteve Lokale (SALAR), i zbatuar nga SALAR International dhe i financuar përmes Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA). BNJVL-ja u përfshi në zbatimin e këtij projekti në vendin tonë së bashku me Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale.






## Четиринаесет општини усвоија локални акциски планови за управување со отпад

Четиринаесет општини од Пелагонискиот и Југозападниот плански регион успешно ги развија и ги усвоија своите локални акциски планови за управување со отпад (ЛАП) што претставува значаен чекор кон промовирање на Интегрираниот регионален систем за управување со отпад во земјата. Активностите беа реализирани во рамките на Проектот „Одржливо управување со отпадот на локално ниво“ инициран и спроведуван од Шведската асоцијација на локални власти (САЛАР). Овие планови, развиени од општините: Битола, Новаци, Прилеп, Охрид, Кичево, Могила, Пласница, Демир Хисар, Долнени, Ресен, Дебрца, Вевчани, Крушево и Кривогаштани означуваат колективна посветеност за подобрување на практиките за управување со отпадот во нашата земја. Вклучувањето на ЗЕЛС во проектот, меѓу другото, произлегува и од определбата за реализирање на активности што ќе придонесат кон исполнување на целите на Зелената агенда, промовирање на циркуларната економија и инклузивната испорака на услуги. Приоритет останува поддршката на интервенциите во животната средина и управувањето со отпад во земјата. Овие локални акциски планови (ЛАП) ќе значат основа кон обезбедување на квалитетни услуги во областа на управувањето со отпад. Воведување систем за селекција на отпад и собирање на одделни текови отпад, како и намалување на количината отпад што завршува на депониите се значајни активности предвидени во општинските планови. Дополнително, тие се фокусираат и кон подигање на свеста во заедниците во однос на одржливите практики за управување со отпадот. Активностите наведени во локалните акциски планови за управување на отпад вклучуваат висок степен на промовирање на пристап заснован на почитување на човековите права и родовата еднаквост, што е во согласност и со заложбите на ЗЕЛС за стратешко интегрирање на родовите перспективи во креирањето на локални политики и планови. Се води грижа и за потребите на маргинализираните групи, односно услугите да бидат подеднакво приспособени на потребите на целата заедница. Искуствата од процесот на креирање на ЛАП-овите за управување на отпад во овие општини придонесува за развој на методолошки алатки за локално акциско планирање, што може да послужи како основа за развој на инклузивни локални акциски планови за управување со отпад во други региони и општини, што не се опфатени со овој Проект. ЗЕЛС останува посветена на поддршката на општините за унапредување на испораката на услуги на локално ниво.




## Katërmbëdhjetë komuna miratuan planet lokale aksionare për menaxhim të mbeturinave

Katërmbëdhjetë komuna nga rajoni i Pellagonisë dhe ai jugperëndimor kanë përgatitur dhe miratuar me sukses planet e tyre aksionare lokale për menaxhimin e mbeturinave (PAL) që paraqet një hap të rëndësishëm drejt promovimit të Sistemit të integruar rajonal të menaxhimit të mbeturinave në vend. Aktivitetet u realizuan në kuadër të projektit “Menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave në nivel lokal”, të iniciuar dhe zbatuar nga Asociacioni Suedez i Autoriteteve Lokale (SALAR). Këto plane të përgatitura nga komunat: Manastir, Novaci, Prilep, Ohër, Kërçovë, Mogillë, Pllasnicë, Demir Hisar, Dollneni, Resnjë, Debërcë, Vevçan, Krushevë dhe Krivogashtan paraqesin një përkushtim kolektiv për përmirësimin e praktikave të menaxhimit të mbeturinave në vendin tonë. Përfshirja e BNJVL-së në projekt, ndër të tjera, del nga vendosmëria për realizimin e aktiviteteve që do të kontribuojnë për përmbushjen e qëllimeve të Agjendës së Gjelbër, promovimin e ekonomisë cirkulare dhe zbatimin gjithëpërfshirës të shërbimeve. Mbështetja e intervenimeve në sferën e mjedisit jetësor dhe menaxhimit të mbeturinave në vend mbetet prioritet. Këto plane aksionare lokale (PAL) do të jenë një bazë për sigurimin e shërbimeve cilësore në sferën e menaxhimit të mbeturinave. Krijimi i një sistemi për selektimin e mbeturinave dhe grumbullimin e llojeve të veçanta të mbeturinave, si dhe zvogëlimi i sasisë së mbeturinave që përfundojnë në deponi janë aktivitete të rëndësishme të parapara në planet komunale. Përveç kësaj, ata fokusohen edhe në ngritjen e vetëdijes në komunitete lidhur me shembujt e qëndrueshëm të menaxhimit të mbeturinave.

Aktivitetet e cekura në planet aksionare lokale për menaxhimin e mbeturinave përfshijnë një shkallë të lartë të promovimit të qasjes që bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore, që është në përputhje edhe me zotimet e BNJVL-së për integrimin strategjik të perspektivave gjinore në krijimin e politikave dhe planeve lokale. Merren parasysh edhe nevojat e grupeve të margjinalizuara, gjegjësisht që shërbimet të përshtaten në mënyrë të barabartë me nevojat e të gjithë komunitetit. Përvojat nga procesi i krijimit të planeve aksionare lokale për menaxhimin e mbeturinave në këto komuna kontribuojnë për zhvillimin e mjeteve metodologjike për planifikimin aksionar lokal, që mund të shërbejë si bazë për zhvillimin e planeve aksionare lokale gjithëpërfshirëse për menaxhimin e mbeturinave në rajone dhe komuna të tjera të cilat nuk përfshihen me këtë projekt. BNJVL-ja mbetet e përkushtuar në përkrahjen të cilën ua jep komunave për avancimin e zbatimit të shërbimeve në nivel lokal.






## ПРЕТСТАВНИЦИ ОД ЗЕЛС УЧЕСТВУВАА НА СВЕЧЕНОТО ОДБЕЛЕЖУВАЊЕ НА 20 ГОДИНИ ОД ОСНОВАЊЕТО НА НАЛАС

„Унапредување на локалната и регионалната соработка“ е мотото со кое беше обележана дваесетгодишнината од основањето на Мрежата на асоцијации на локални власти на земјите од Југоисточна Европа (НАЛАС). Мрежата е посветена на поттикнување ефективно локално управување и одржлив развој во земјите од Југоисточна Европа, обединувајќи 13 здруженија на локални власти и околу 9000 единци на локална самоуправа, кои опфаќаат повеќе од 80 милион граѓани од овој регион. ЗЕЛС е една од асоцијациите, основачи на НАЛАС и е нејзин активен член.

На свечената седница, што беше организиран на 18 април, 2024 година во Бар, Црна Гора, учествуваа двајца претставници од ЗЕЛС. Пред присутните се обрати БерндВорингер, потпретседател на Конгресот на локални и регионални власти при Советот на Европа кој посочи дека оваа година и Советот на Европа слави 75 години постоење, а Конгресот има јубилеј од 30 годишни, што е потврда за посветеноста на Европската Унија на заложбата за унапредување на улогата на локалните и регионалните власти. Присутните делегати и гости ги поздрави и претседателот на НАЛАС, Ергун Туран, градоначалник на Општина Фатих, (Турција) како и Мараш Дукај, министер за јавна администрација на Црна Гора, а за моментите на основањето на НАЛАС присутните ги потсети првиот претседател – Тарзан Милошевиќ, некогашен градоначалник на општина во Црна Гора. Се говореше за значењето на заеднички настап на локалните власти од регионот, изнаоѓањето на решенија за бројните предизвици со кои се соочуваат, а беше истакнаа и

## PËRFAQËSUES NGA BNJVL-JA PJESËMARRËS NË SHËNIMIN SOLEMN TË 20 VJETORIT TË THEMELIMIT TË NALAS-IT

“Avancimi i bashkëpunimit lokal dhe rajonal” është motoja me të cilën u shënua 20 vjetori i themelimit të Rrjetit të Asocioneve të Autoriteteve Lokale të Vendeve të Evropës Juglindore (NALAS). Rrjeti është i përkushtuar për inkurajimin e qeverisjes efektive lokale dhe zhvillimin e qëndrueshëm në vendet e Evropës Juglindore, duke bashkuar 13 shoqata të autoriteteve lokale dhe rreth 9000 njësish të vetëqeverisjes lokale, të cilat përfshijnë më shumë se 80 milionë qytetarë të këtij rajoni. BNJVL-ja është një nga asociacionet, themeluese të Rrjetit dhe është anëtare e saj aktive.

Në seancën solemne që u organizua më 18 prill 2024, në Tivar të Malit të Zi, morën pjesë dy përfaqësues të BNJVL-së. Para të pranishmëve u drejtua Bernd Voringer, nënkryetar i Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Këshillin e Evropës, i cili theksoi se këtë vit shënimi i jubileut të 75 vjetorit të ekzistencës së Këshillit të Evropës dhe jubileut të 30-vjetorit të ekzistencës së Kongresit është një konfirmim i përkushtimit të Bashkimit Evropian për angazhimin për avancimin e rolit të autoriteteve lokale dhe rajonale. Delegatët dhe mysafirët e pranishëm i përshëndeti edhe kryetari i NALAS-it, Ergun Turan, kryetar i Komunës Fatih (Turqia), si dhe Marash Dukaj, Ministër i Administratës Publike të Malit të Zi, ndërsa presidenti i parë, Tarzan Milosheviq, kryetar i dikurshëm i një komune në Mal të Zi, i kujtoi të pranishmit për momentet e themelimit të NALAS-it. U diskutua për rëndësinë e angazhimit të përbashkët të autoriteteve lokale të rajonit, gjetjen e zgjidhjeve për sfidat e shumta me të cilat ballafaqohen ato, ndërsa u theksua edhe rëndësia e shkëmbimit të ndërsjellë të shembujve të mirë si një mënyrë për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve për të gjithë qytetarët në rajon. Kuvendi i NALAS-it, në seancën që

важноста на меѓусебното споделување на добрите примери, како начин на подобрување на квалитетот на услугите за сите граѓани во регионот. Собранието на НАЛАС на седницата што ја одржа следниот ден, за нов претседател со мандат 2024-2025 година го назначи Душан Раичевиќ, градоначалник на Бар, додека за потпретседатели беа избрани градоначалниците на градовите Ријека, Вулцана Баи и Урошевац. Изборот се утврдува по пат на ротирање, според азбучен ред на асоцијациите, членки на Мрежата. На седницата беше поддржано и основање на Канцеларија во рамките на НАЛАС, како единствен центар за Пактот на градоначалниците за Југоисточна Европа за енергија и клима.

e mbajti ditën e nesërme, për kryetar të ri me mandat për periudhën 2024-2025 e emëroi Dushan Raiçeviqin, kryetar të komunës së Tivarit, ndërsa kryetarët e qyteteve të Rijekës, Vulcana Bai-së dhe Ferizajit u zgjodhën nënkryetarë. Në seancë u miratuan edhe dokumente të rëndësishme nga funksionimi i Rrjetit, ndërsa u mbështet edhe themelimi i një zyre në kuadër të NALAS-it, si qendër e vetme e Paktit të Kryetarëve të Komunave për Evropën Juglindore për energjinë dhe klimën. Zgjedhja bëhet me anë të rotacionit, sipas rendit alfabetik të asociacioneve, anëtare të Rrjetit. Në seancë u mbështet edhe themelimi i një zyre në kuadër të NALAS-it, si qendër e vetme e Paktit të Kryetarëve të Komunave për Evropën Juglindore për energjinë dhe klimën.

### Општина Кавадарци ја прими наградата „Зелени шампиони„ на Западен Балкан, во категоријата „Практиката за одржливо земјоделство"

Во рамките на овој настан, на вториот форум - „Зелена агенда на локалните самоуправи во Западен Балкан"добитниците на награди на објавениот конкурс „Зелени шампиони" на Западен Балкан" ги презентираа своите добри практики. Општина Кавадарци ја доби наградата во областа „Практиката за одржливо земјоделство". Изборот е направен од страна на Комисијата за оценување за освојување на оваа награда во категоријата „Иновации и креативност во решавањето на еколошките предизвици – загадувањето".Овој форум беше организиран во соработка со ГИЗ и Отворен регионален фонд за ЈИЕ- Енергија, транспорт и заштита на климата. На форумот беа поканети повеќе од 100 учесници кои обезбедија исклучително корисна платформа за дискусија во која се вклучија и победниците кои говореа за спроведувањето на Зелената агенда, прикажувајќи ги нивните иновативни и еколошки одржливи решенија. Свои видувања изложија и градоначалници од повеќе градови од ЈИЕ, како градоначалничките на Сараево и на Подгорица и градоначалниците на Риека и Бар, кои информираа дека посветено работат на многу зелени проекти, но со скромни финансиски ресурси и апелираа до централните власти да обезбедат повеќе средства за проекти од оваа област.

### Komuna e Kavadarit mori çmimin "Kampionët e gjelbër" të Ballkanit Perëndimor në kategorinë "Praktika e bujqësisë së qëndrueshme"

Në kuadër të kësaj ngjarjeje, në forumin e dytë "Agjenda e gjelbër e vetëqeverisjeve lokale në Ballkanin Perëndimor", fituesit e çmimeve në konkursin e shpallur "Kampionët e gjelbër" të Ballkanit Perëndimor prezantuan shembujt e tyre të mirë. Komuna e Kavadarit fitoi çmimin në kategorinë "Praktika e bujqësisë së qëndrueshme". Përzgjedhja është bërë nga Komisioni i vlerësimit për të fituar këtë çmim në kategorinë "Inovacionet dhe kreativiteti në zgjidhjen e sfidave ekologjike–ndotjes". Ky forum u organizua në bashkëpunim me GIZ-in dhe Fondin e Hapur Rajonal për EJL-në – Energjia, transporti dhe mbrojtja e klimës. Në forum u ftuan më shumë se 100 pjesëmarrës të cilët siguruan një platformë jashtëzakonisht të dobishme për diskutim, në të cilin u përfshinë edhe fituesit të cilët folën për zbatimin e Agjendës së Gjelbër, duke prezantuar zgjidhjet e tyre inovative dhe të qëndrueshme ekologjike. Perceptimet e tyre i prezantuan edhe kryetarët e më shumë qyteteve të Evropës Juglindore, si kryetaret e qyteteve të Sarajevës dhe Podgoricës dhe kryetarët e qyteteve të Rijekës dhe Tivarit, të cilët informuan se po punojnë me përkushtim në shumë projekte të gjelbra, por me resurse modeste financiare dhe u apeluan autoriteteve qendrore që të sigurojnë më shumë fonde për projekte të kësaj sfere.





## МУЛТИДИСЦИПЛИНАРЕН ПРИСТАП КАКО ОДГОВОР ВО БОРБАТА ПРОТИВ ДЕЗИНФОРМАЦИИ И ДИГИТАЛНО РОДОВО- БАЗИРАНО НАСИЛСТВО НА ЛОКАЛНО НИВО

Општинските советници, членови на трите тематски работни групи: за родова еднаквост; за односи меѓу заедниците и за младински политики на локално ниво, имаа можност да дискутираат за справување со дезинформациите, говорот на омраза и дигиталното родово- базирано насилство на локално ниво. Советниците беа запознаени како да ги препознаваат дезинформациите, како да го спречат нивното ширење и како да се заштити локалната самоуправа и граѓаните од нивното лошо влијание. Оваа активност беше реализирана во рамките на Проектот „Зајакнување на општинските совети- Фаза 2", на 17 април, 2024 година, во Скопје, во организација на Програмата за развој на Обединетите нации -УНДП и во партнерство со ЗЕЛС. Поддршка на настанот даде и Проектот „Млади за инклузија, еднаквост и доверба", кој исто така, се имплементиран од страна на УНДП. На настанот беа поканетите и координаторите/ките за еднакви можности од сите 30 партнерски општини од проектот.

Говорот на омраза и родово базирани дезинформации во дигиталниот свет беа темите од првата сесија, а беа разгледани и ефективни стратегии за превенција и заштита. Низ интерактивната сесија се потенцираше значењето на мултидисциплинарниот пристап и ангажман на сите чинители во создавањето на поинклузивен и безбеден дигитален простор за сите. Втората сесија опфаќаше запознавање со поимот за родово -базирано насилство и механизмите за заштита од него, како тоа влијае на жените и младите во општеството. Фокус беше ставен на тоа со кои негативни последици се соочуваат жртвите на дигиталното насилство и кои правни регулативи и други механизми се на располагање за пријавување и заштита каде најзасегнати се жените и младите. Беше посочено дека жените во политиката се чести жртва на говор на омраза, особено во време на избори, но и во текот на целокупниот политички ангажман. Презентирани беа и истражувања за

## QASJA MULTIDISIPLINARE SI PËRGJIGJE NË LUFTËN KUNDËR DEZINFORMATAVE DHE DHUNËS SË BAZUAR DIGJITALE GJINORE NË NIVEL LOKAL

Këshilltarët komunalë, anëtarë të tre grupeve punuese tematike: për barazi gjinore, për marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve dhe për politikat rinore në nivel lokal, patën mundësi të diskutojnë për ballafaqimin me dezinformatat, gjuhën e urrejtjes dhe dhunën e bazuar digjitale gjinore në nivel lokal. Këshilltarët u informuan lidhur me mënyrën se si të identifikojnë dezinformatat, si të parandalojnë përhapjen e tyre dhe si të mbrohet vetëqeverisja lokale dhe qytetarët nga ndikimi i tyre i keq. Ky aktivitet u realizua në kuadër të projektit "Përforcimi i këshillave komunale – Faza 2", më 17 prill 2024, në Shkup, në organizim të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara – UNDP dhe në partneritet me BNJVL. Ngjarja u mbështet edhe nga projekti "Të rinjtë për përfshirje, barazi dhe mirëbesim", i cili gjithashtu zbatohet nga ana e UNDP-së. Në këtë ngjarje u ftuan edhe koordinatorët/koordinatoret për mundësi të barabarta nga të gjitha 30 komunat partnere të projektit.

Gjuha e urrejtjes dhe dezinformatat e bazuara gjinore në botën digjitale ishin temat e sesionit të parë, ndërsa u diskutuan edhe strategjitë efektive për parandalim dhe mbrojtje. Nëpër sesionin interaktiv u theksua rëndësia e qasjes multidisiplinare dhe angazhimi i të gjithë aktorëve në krijimin e një hapësire më gjithëpërfshirëse digjitale dhe të sigurt për të gjithë. Sesioni i dytë përfshinte njohjen me nocionin e dhunës së bazuar gjinore dhe mekanizmat e mbrojtjes nga ajo, si ndikon ajo ndaj grave dhe të rinjve në shoqëri. Fokusi u vu në pasojat negative me të cilat ballafaqohen viktimat e dhunës digjitale dhe rregulloret ligjore dhe mekanizmat e tjerë të cilat janë në dispozicion për raportimin dhe mbrojtjen e kësaj dhune, nga e cila më së shumti preken gratë dhe të rinjtë. U theksua se gratë në politikë janë viktima të shpeshta të gjuhës së urrejtjes, sidomos gjatë zgjedhjeve, por edhe gjatë gjithë angazhimit të tyre politik. U prezantuan edhe

дигиталното насилство на национално и на глобално ниво. На крајот од работилницата по еден претставник од трите тематски работни групи презентираше согледувања за последиците што овие појави ги оставаат врз општината и граѓаните. Посочија на порастот на врсничко насилство кај младите во училиштата и надвор од нив; говор на омраза најчесто насочен кон жените- политичари и пренесување на лажни вести. Советниците и претставниците од општините беа информирани за содржините на новата дигитална платформа „https://jasno.mk/" на Здружението на новинари на Македонија (ЗНМ) и УНДП. Целта на оваа платформа е да им понуди ресурси на граѓаните и на новинарите со кои ќе ги препознаат дезинформации, особено од родов карактер. Оваа платформа треба да придонесе во процесот на подигање на свеста и зајакнување на капацитетите на локалните заедници да ги препознаат дезинформации и говорот на омраза.

hulumtimet për dhunën digjitale në nivel kombëtar dhe global. Në fund të punëtorisë, nga një përfaqësues nga tre grupet punuese tematike prezantoi perceptimet e tyre për pasojat që këto dukuri lënë mbi komunën dhe qytetarët. Ata theksuan rritjen e dhunës së bashkëmoshatarëve te të rinjtë në shkolla dhe jashtë tyre, gjuhën e urrejtjes më së shumti të drejtuar kah gratë-politikane dhe transmetimin e lajmeve të rreme. Këshilltarët dhe përfaqësuesit e komunave u informuan për përmbajtjen e platformës së re digjitale https://jasno.mk/ të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) dhe UNDP-së. Qëllimi i kësaj platforme është të ofrojë resurse për qytetarët dhe gazetarët për të identifikuar dezinformatat, veçanërisht ato të natyrës gjinore. Kjo platformë duhet të kontribuojë në procesin e ngritjes së vetëdijes dhe përforcimit të kapaciteteve të komuniteteve lokale për t'i identifikuar dezinformatat dhe gjuhën e urrejtjes.

## ДВАЕСЕТ И ШЕСТИ АПРИЛ -ДЕН НА ЗЕЛС И ДЕН НА ОПШТИНИТЕ

Оваа година, на 26 април 2024 година, ЗЕЛС го прослави својот 52. роденден. Во 1972 година, на овој ден било одржано основачко собрание на кое била конституирана тогашната Заедница на општините и градовите на Македонија (ЗОГМ). Иницијативата била на претседателите на собранијата на општините: Куманово, Кочани, Охрид, Скопје и Тетово. Претставници од 34 македонски општини ја дале својата согласност за основање, а потоа и за доброволно пристапување во Заедницата. Бил усвоен Статутот на Заедницата и биле донесени важни одлуки за начинот на нејзината работа. Со тоа, како што е запишано во архивските документи, „создадена е цврста платформа за најширока соработка на општините во Македонија". Па така, во Статутот на ЗЕЛС, 26 април е утврден како Ден на ЗЕЛС и Ден на општините.

Роденденот на ЗЕЛС претставува и потсетување на целиот процес на градење децентрализиран систем во државата. Во периодот пред осамостојувањето на земјата, општините имале дури и државнички функции, потоа, по независноста на државата, настанува одреден „вакуум" и се смета за најлош период за локалната власт, сè до периодот на повторно јакнење на децентрализацијата на власта во земјава, чија имплементација, официјално започна на 1 јули 2005 година. Во овој период, со својата сила и потенцијал ЗЕЛС дава голем придонес и има значајна улога во процесот на донесување нови законски решенија, во креирањето на структурата, функционирањето, надлежностите и финансирањето на локалната власт. ЗЕЛС е посветена на создавање систем на локална самоуправа по мерка на граѓаните и прерасна во авторитативна, респектирана и моќна заедница. Мал е бројот на асоцијации што можат да се пофалат со ваква импозантна бројка на сопствено континуирано градење и развивање. Сега, ЗЕЛС обединува 80 општини и Градот Скопје, како посебна единица на локалната самоуправа, и продолжува да ја остварува својата примарна функција, а тоа е да ги реализира сите оние барања што ги имаат единиците на локалната самоуправа и да ги застапува нивните интереси.

## NJËZET E GJASHTË PRILLI – DITA E BNJVL-SË DHE DITA E KOMUNAVE

Sivjet, më 26 prill 2024, BNJVL-ja festoi ditëlindjen e saj të 52-të. Në vitin 1972 në këtë ditë u mbajt Kuvendi themelues në të cilin u konstituua Bashkësia e atëhershme e komunave dhe qyteteve të Maqedonisë (BKQM). Iniciativën e kanë marrë kryetarët e kuvendeve të komunave: Kumanovë, Koçan, Ohër, Shkup dhe Tetovë. Përfaqësues nga 34 komuna të Maqedonisë dhanë pëlqimin e tyre për themelim, e më pas për anëtarësim vullnetar në Bashkësi. U miratua Statuti i Bashkësisë dhe u morën vendime të rëndësishme për mënyrën e funksionimit të saj. Me këtë, siç është shënuar në dokumentet arkivore, "u krijua një platformë e fortë për bashkëpunim sa më të gjerë të komunave në Maqedoni". Kështu, në Statutin e BNJVL-së, 26 prilli është përcaktuar si Dita e BNJVL-së dhe Dita e komunave.

Ditëlindja e BNJVL-së është edhe përkujtim i gjithë procesit të ndërtimit të sistemit të decentralizuar në vend. Në periudhën para pavarësisë së vendit, komunat kishin edhe funksione shtetërore, pastaj pas pavarësimit të shtetit krijohet një "vakum" dhe konsiderohet periudha më e keqe për pushtetin lokal, deri në periudhën e forcimit të serishëm të decentralizimit të pushtetit në vend, zbatimi i të cilit filloi zyrtarisht më 1 korrik 2005. Në këtë periudhë, me fuqinë dhe potencialin e saj, BNJVL-ja jep një kontribut të madh dhe ka rol të rëndësishëm në procesin e miratimit të zgjidhjeve të reja ligjore, në krijimin e strukturës, funksionimit, kompetencave dhe financimit të pushtetit lokal. BNJVL-ja është e përkushtuar për krijimin e sistemit të vetëqeverisjes lokale sipas nevojave të qytetarëve dhe është shndërruar në një bashkësi autoritative, të respektuar dhe të fuqishme. Numri i sasociacioneve që mund të mburren me një numër kaq mbresëlënës të ndërtimit dhe zhvillimit të tyre të vazhdueshëm është i vogël. Tani BNJVL-ja bashkon 80 komuna dhe Qytetin e Shkupit, si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale dhe vazhdon ta kryejë funksionin e saj primar, që është realizimi i të gjitha atyre kërkesave që kanë njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe përfaqësimi i interesave të tyre.

## ПРЕТСЕДАТЕЛОТ НА ЗЕЛС СЕ ОБРАТИ НА ОТВОРАЊЕТО НА МЕЃУНАРОДНАТА КОНФЕРЕНЦИЈА ЗА ЗЕЛЕН РАЗВОЈ, ЗЕЛЕНА ИНФРАСТРУКТУРА И ЗЕЛЕНИ ТЕХНОЛОГИИ „ГРЕДИТ 2024“ ВО СКОПЈЕ

- „Нашиот град, како и многу други, се соочува со предизвици кои бараат смели и иновативни решенија. Од голема важност е потребата од еколошка одржливост и борбата против ефектите од климатските промени. Затоа, кога гледаме кон иднината и управувањето со урбаните средини од приоритетно значење е дизајнирањето на стратегиски планови и примена на технологии насочени кон подобрување на екологијата и поттикнување на одржлив раст и развој на заедницата.“ Ова го истакна претседателот на ЗЕЛС, Орце Ѓорѓиевски, во своето обраќање при отворањето на петтата Меѓународната конференција за зелен развој, зелена инфраструктура и зелени технологии „ГРЕДИТ 2024“, на 16 мај, 2024 година, во Скопје. Тој нагласи дека придобивките од зелената инфраструктура немаат само еколошки ефекти, туку обезбедуваат и економски просперитет и социјална еднаквост. – „Со инвестирање во проекти за зелена инфраструктура, создаваме работни места, ги стимулираме локалните економии и привлекуваме нови бизниси и инвестиции. Со овозможувањето на еднаков пристап до зелени јавни простори и одржливи ресурси, осигуруваме дека сите жители, без оглед на нивниот социјален статус и финансиска моќ, можат да уживаат во придобивките од креираниот град кој ќе биде поздрава средина за живот“, нагласи Ѓорѓиевски. При тоа, претседателот на ЗЕЛС посочи дека за поголеми успеси од голема важност е и соработката и партнерскиот однос на локалната со централната власт, но и вклучување на целата академска јавност, бизнис заедницата, граѓанските организации и населението. На овој настан претседателот на ЗЕЛС оствари средба и со ректорот на УКИМ, Проф. д-р Биљана Ангелова.

## KRYETARI I BNJVL-SË FOLI NË HAPJEN E KONFERENCËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM TË GJELBËR, INFRASTRUKTURË TË GJELBËR DHE TEKNOLOGJI TË GJELBRA “GREDIT 2024” NË SHKUP

– “Qyteti ynë, si shumë të tjerë, përballet me sfida që kërkojnë zgjidhje të guximshme dhe inovative. Me rëndësi të madhe është nevoja për qëndrueshmëri ekologjike dhe luftë kundër efekteve të ndryshimeve klimatike. Prandaj, kur shikojmë drejt ardhmërisë dhe menaxhimit të mjediseve urbane, hartimi i planeve strategjike dhe aplikimi i teknologjive që i drejtohen përmirësimit të ekologjisë dhe inkurajimit të rritjes së qëndrueshëm dhe zhvillimit të komunitetit është me rëndësi prioritare”. Këtë e theksoi kryetari i BNJVL-së, Orce Gjorgjievski në fjalimin e tij në hapjen e Konferencës së pestë ndërkombëtare për zhvillim të gjelbër, infrastrukturë të gjelbër dhe teknologji të gjelbra “GREDIT 2024”, më 16 maj 2024, në Shkup. Ai theksoi se përfitimet e infrastrukturës së gjelbër nuk kanë vetëm efekte ekologjike, por sigurojnë edhe prosperitet ekonomik dhe barazi sociale. – “Duke investuar në projekte të infrastrukturës së gjelbër, ne krijojmë vende pune, stimulojmë ekonomitë lokale dhe tërheqim biznese dhe investime të reja. Duke mundësuar një qasje të barabartë në hapësirat e gjelbra publike dhe resurset e qëndrueshme, ne sigurojmë që të gjithë banorët, pavarësisht statusit të tyre social dhe fuqisë së tyre financiare, të mund të gëzojnë përfitimet e qytetit të krijuar që do të jetë një mjedis më i shëndetshëm për jetën e tyre”, theksoi Gjorgjievski. Në të njëjtën kohë, kryetari i BNJVL-së theksoi se për suksese më të mëdha me rëndësi të madhe është edhe bashkëpunimi dhe partneriteti i pushtetit lokal me pushtetin qendror, por edhe përfshirja e gjithë opinionit akademik, komunitetit të biznesit, organizatave të shoqërisë civile dhe mbarë popullatës. Në këtë ngjarje, kryetari i BNJVL-së realizoi takim edhe me rektorin e UKIM-it, prof. d-r Biljana Angellova.








## ЗАПОЧНА ПРОЦЕСОТ НА РЕ-АКРЕДИТАЦИЈА НА ЗЕЛС ЗА УЛОГАТА НА ТЕХНИЧКИ СЕКРЕТАРИЈАТ ЗА СПРОВЕДУВАЊЕ НА МЕЃУНАРОДНАТА ПРОГРАМА БФЦ СЕЕ ВО НАШАТА ЗЕМЈА

Во просториите на ЗЕЛС, на 28 мај 2024 година, пристигна двочлена експертска екипа на претставници од Националната алијанса на локален економски развој (НАЛЕД). Оваа организација од Република Србија е сопственик на лиценцата на меѓународната програма за сертификација на градови и општини со поволно деловно опкружување во Југоисточна Европа, БФЦ СЕЕ (Business Friendly Certification South East Europe - BFC SEE). ЗЕЛС во оваа меѓународна програма се вклучи од 2012 година и ја има улогата на акредитиран технички секретаријат за нејзино спроведување во нашата земја. Целта на посетата беше да се утврди подготвеноста и способноста на ЗЕЛС за натамошно спроведување на програмата БФЦ СЕЕ во општините, по последно стекнатата акредитација од 2016 година. Предизвиците што произлегоа од пандемијата со КОРОНА вирусот, а потоа и од енергетската криза, го пролонгираа навременото започнување на постапката за реакредитација на ЗЕЛС.

Експертите темелно го утврдуваа начинот на досега реализираните активности на ЗЕЛС за спроведувањето на утврдените процеси за стекнување сертификат БФЦ СЕЕ, од страна на општините. Експертите, во повеќечасовни разговори со менаџерскиот тим на ЗЕЛС и со техничките координатори на програмата, се интересираа и за начинот на спроведување на постапката за обука и полагањето на евалуаторите кои ја разгледуваат и оценуваат доставената документација од општините. Беа разгледани и постапките на утврдување на лица за верификатори, кои, исто така, минуваат низ постапка за сертифицирање. Тоа се експерти кои всушност го даваат последниот збор дали една општина навистина на листата на своите стратегиски приоритети високо ги постигнала стандардите за обезбедување соодветни услови за соработка со бизнис-заедницата и развојот на локалната економија. Експертите се интересираа и за начинот на кој ЗЕЛС, како технички секретаријат за нашата земја, располага со финансиските

## FILLOI PROCESI I RI-AKREDITIMIT TË BNJVL-SË PËR ROLIN E SEKRETARIATIT TEKNIK PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT NDËRKOMBËTAR BFC SEE NË VENDIN TONË

Më 28 maj 2024, në hapësirat e BNJVL-së mbërriti ekipi dy anëtarësh i ekspertëve, përfaqësues të Aleancës Nacionale për Zhvillim Ekonomik Lokal (NALED). Kjo organizatë nga Republika e Serbisë është pronare e licencës së programit ndërkombëtar BFC SEE për certifikimin e qyteteve dhe komunave me mjedis të favorshëm afarist në Evropën Juglindore (Business Friendly Certification South East Europe - BFC SEE). BNJVL-ja u përfshi në këtë program ndërkombëtar që në vitin 2012 dhe ka rolin e sekretariatit të akredituar teknik për zbatimin e tij në vendin tonë. Qëllimi i vizitës ishte të konstatohet gatishmëria dhe aftësia e BNJVL-së për zbatim të mëtutjeshëm të programit BFC SEE në komuna, pas akreditimit të fundit të fituar në vitin 2016. Sfidat që dolën nga pandemia e virusit CORONA dhe më pas nga kriza energjetike e prolonguan fillimin me kohë të procedurës për ri-akreditimin e BNJVL-së.

Ekspertët në mënyrë të detajuar përcaktonin mënyrën e aktiviteteve të realizuara deri më tani të BNJVL-së për zbatimin e proceseve të përcaktuara për marrjen e certifikatës BFC SEE nga ana e komunave, mënyrën e informimit të komunave për rëndësinë e kësaj certifikate ndërkombëtare dhe përfitimet për komunat. Ekspertët, në bisedimet disaorëshe me ekipin menaxhues të BNJVL-së dhe me koordinatorët teknikë të Programit, interesoheshin edhe për mënyrën e zbatimit të procedurës për trajnimin dhe kalimin e vlerësuesve të cilët shqyrtojnë dhe vlerësojnë dokumentacionin e dorëzuar nga komunat. U shqyrtuan edhe procedurat e përcaktimit të personave për verifikues, të cilët gjithashtu kalojnë nëpër një procedurë certifikimi. Këta janë ekspertë të cilët në fakt japin fjalën e fundit nëse një komunë vërtet në listën e prioriteteve të saja strategjike ka arritur në nivel të lartë standardet për sigurimin e kushteve adekuate për bashkëpunim me komunitetin e biznesit dhe zhvillimin e ekonomisë lokale. Ekspertët interesoheshin edhe për mënyrën në të cilën BNJVL-ja, si sekretariat teknik për vendin tonë, menaxhon me resurset financiare për zbatimin e

ресурси за спроведување на програмата. По разгледувањето и на потребната документација, експертскиот тим утврди одредени забелешки за кои ЗЕЛС треба во период од дваесетина дена да се потруди да ги надмине со цел целосно исполнување на сите потребни услови за реакредитирање. Една од забелешките се однесува и на исполнување на правилото за обезбедување соодветен број на единици на локалната самоуправа што ќе се вклучат во процесот на сертифицирање или ресертифицирање. За Република Северна Македонија условот е од најмалку три локални единици, а засега за сертификација се пријави Општина Кочани, а за ресертифицирање Градот Скопје.

Според независно спроведено истражување, се потврдило дека во општините кои се стекнале со сертификат БФЦ СЕЕ, условите за водење бизнис се за 76 % подобри, во однос на оние што немаат ваков печат на стандард. Исто така, утврдено е дека сертифицираните општини, во просек имаат трипати повеќе инвестиции од оние што не се сертифицирани со БФЦ. Понатаму, од сите општини од регионот (12) кои во изминатиот период беа наведени на листата на „Фајненшл тајмс"на топ дестинации за инвестирање во Европа (FDI Cities of the Future) 80 % се токму оние што имаат сертификат БФЦ СЕЕ, меѓу кои беа и единиците на локалната самоуправа од нашата земја. Преку мрежата БФЦ СЕЕ, беа поттикнати нови регионални иницијативи (е-дозвола за градба....) и беа спроведени проекти со поддршка на големи меѓународни институции како што се: ГИЗ, СДЦ УСАИД, СИДА и Светската банка. Оваа програма, исто така, поттикна 20 институции и организации од седумте земји (Албанија, Босна и Херцеговина, Република Македонија, Косово, Србија, Хрватска и Црна Гора) да ја зајакнат регионалната соработка и да обезбедат размена на знаења меѓу ресорните министерства, стопанските комори, здруженијата на општини, развојните агенции, граѓанските организации и универзитетите, општините и градовите, во рамките на платформата „Партнерство за конкурентен регион" (CORE).

Programit. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të nevojshëm, ekipi i ekspertëve konstatoi vërejtje të caktuara, të cilat BNJVL-ja duhet të përpiqet t'i tejkalojë në periudhë prej njëzet ditësh me qëllim që të plotësojë tërësisht të gjitha kushtet e nevojshme për ri-akreditim. Njëra nga vërejtjet ka të bëjë edhe me përmbushjen e rregullës për sigurimin e një numri adekuat të njësive të vetëqeverisjes lokale që do të përfshihen në procesin e certifikimit apo ricertifikimit. Për Republikën e Maqedonisë së Veriut, kushti është të ketë së paku tri njësi lokale, ndërsa deri më tani për certifikim ka aplikuar vetëm Komuna e Koçanit, ndërsa për ricertifikim vetëm Qyteti i Shkupit.

Sipas një hulumtimi të kryer në mënyrë të pavarur, është konstatuar se në komunat që kanë marrë certifikatën BFC SEE, kushtet për bërjen e biznesit janë 76% më të mira, në krahasim me ato që nuk e kanë këtë vulë të standardit. Gjithashtu është konstatuar se komunat e certifikuara mesatarisht kanë tre herë më shumë investime se ato që nuk janë të certifikuara me BFC. Pastaj, nga të gjitha komunat në rajon (12) që u renditën në periudhën e kaluar në listën e gazetës Financial Times të destinacioneve kryesore të investimeve në Evropë (FDI Cities of the Future), 80% janë pikërisht ato që kanë certifikatën BFC SEE, ndër të cilat ishin edhe njësi të vetëqeverisjes lokale nga vendi ynë. Përmes rrjetit BFC SEE u inkurajuan iniciativa të reja rajonale (e-leja për ndërtim...) dhe u zbatuan projekte me mbështetjen e institucioneve të mëdha ndërkombëtare si: GIZ, SDC, USAID, SIDA dhe Banka Botërore. Ky program inkurajoi gjithashtu 20 institucione dhe organizata nga të shtatë vendet (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Republika e Maqedonisë, Kosova, Serbia, Kroacia dhe Mali i Zi) për të forcuar bashkëpunimin rajonal dhe për të siguruar shkëmbimin e njohurive ndërmjet ministrive të resorit, dhomave ekonomike, shoqatave të komunave, agjencive të zhvillimit, organizatave të shoqërisë civile dhe universiteteve, komunave dhe qyteteve, në kuadër të platformës "Partneriteti për Rajon Konkurrues" (CORE).

## ОПШТИНИТЕ МОЖЕ ДА КОНКУРИРААТ ЗА ГРАНТ ДО 20 000 ИЛИ ДО 50 000 ДОЛАРИ ЗА ИЗРАБОТКА НА ТЕХНИЧКА ДОКУМЕНТАЦИЈА ЗА ИНФРАСТРУКТУРНИ ПРОЕКТИ ЗА НАМАЛУВАЊЕ НА ЗАГАДУВАЊЕТО НА ВОЗДУХОТ

Општините и центрите за развој на планските региони, до 10 јуни 2024 година, може да поднесат барања за обезбедување на финансиска помош, во рамките на Фондот за техничка документација, до 20 000 или до 50 000 долари за изработка на техничка документација за инфраструктурни проекти. Поднесувањето на барањата е преку платформата https://apliciraj.brr.gov.mk, а инструкции околу користењето на платформата ќе бидат обезбедени во рамките на заеднички онлајн состанок што ќе биде дополнително закажан. Фокусот на овој повик е ставен на проектите што имаат потенцијал да го намалат загадувањето на воздухот од цврсти честички, јаглерод моноксид, азотни оксиди, сулфур диоксид, испарливи органски соединенија, метан, амонијак и

## KOMUNAT MUND TË KONKURROJNË PËR GRANTIN DERI NË 20.000 OSE DERI NË 50.000 DOLLARË PËR PËRGATITJEN E DOKUMENTACIONIT TEKNIK PËR PROJEKTET INFRASTRUKTURORE PËR REDUKTIMIN E NDOTJES SË AJRIT

Komunat dhe qendrat për zhvillimin e rajoneve planifikuese, deri më 10 qershor 2024, mund të parashtrojnë kërkesa për të siguruar ndihmë financiare, në kuadër të Fondit për dokumentacionin teknik, deri në 20.000 ose deri në 50.000 dollarë për përgatitjen e dokumentacionit teknik për projektet infrastrukturore. Parashtrimi i kërkesave bëhet përmes platformës https://apliciraj.brr.gov.mk, ndërsa instruksionet lidhur me përdorimin e platformës do të sigurohen në kuadër të një takimi të përbashkët online që do të caktohet në mënyrë shtesë. Fokusi i kësaj thirrjeje është vënë në llojet e projekteve që kanë potencial për të reduktuar ndotjen e ajrit nga grimcat e ngurta, monoksidi i karbonit, oksidet e azotit, dyoksidi i squfurit, komponimet e avullueshme

други загадувачки материи. За таа цел, проектите треба да вклучуваат мерки што ќе ги намалат емисиите на овие материи од клучните извори: сообраќајот, системите за греење, цврстиот отпад и други, каде општините имаат надлежност.

Финансиската помош до 50 000 американски долари е наменета за проекти од општините со седиште во град што имаат повеќе од 25 000 жители, или проекти што ќе бидат поднесени од центрите за развој на планските региони. Општините со седиште во град или село што имаат помалку од 25 000 жители може да конкурираат со проекти за финансиска помош до 20 000 долари. Средствата од грантот се наменети за финансирање на изработката на техничка документација, односно за потребните проектантски и поврзаните консултантски услуги. Обврска на општините и центрите за развој на планските региони што ќе добијат грант е да финансираат најмалку 20 % од бараните средства од грантот, согласно со проценетите трошоци за изработка на предвидената техничка документација. Избраните општини или центри за развој на планските региони ќе потпишат соодветни договори според кои ќе ја преземат одговорноста за реализација на грантовите. Главна цел на овој повик е да се обезбедат проекти со висококвалитетна техничка документација која ќе биде соодветна на барањата на клучните меѓународни и домашни извори на финансирање.

Фондот за техничка документација претставува инструмент за финансиска и техничка поддршка во реализацијата на инфраструктурни проекти на локално, меѓу- општинско и регионално ниво и е воспоставен со поддршка на проектот на УНДП „Јакнење на општинските капацитети за имплементација на проекти", финансиран од Шведската агенција за меѓународна соработка (СИДА) и Бирото за регионален развој. Проектот се спроведува во партнерство со Бирото за регионален развој, Министерството за локална самоуправа, ЗЕЛС, општините и центрите за регионален развој и други партнери и засегнати страни на национално и локално ниво. Овој повик, организиран од УНДП е втор од вкупно трите планирани повици во рамките на тековната втора фаза на проектот (2022 – 2026). Третиот повик ќе биде спроведен од Бирото за регионален развој.

Во првата фаза беше спроведено институционализирање и надградба на Фондот за техничка документација. Се имплементираат 13 грантови (општински и регионални проекти). Во фаза на подготовка се вкупно 20 комплети техничка документација за вкупно 47 проекти. За овие активности, беа договорени девет тренери за реализација на развојот на капацитети на работното место, насочени кон релевантниот општински персонал. Дополнително, се одржуваат сесии за обука за антикорупција и вклучување на родовите аспекти во главните политики за зајакнување на капацитетите на институциите чии проекти се финансираат. Планирана е изработка на прирачници, а во тек е и изработка на функционална анализа за да се олесни трансферот на Фондот за техничка документација од УНДП кон Бирото за рамномерен развој.

organike, metani, amoniaku dhe materiet e tjera ndotëse. Për këtë qëllim, projektet duhet të përfshijnë masa që do të reduktojnë emetimet e këtyre materieve nga burimet kryesore: trafiku, sistemet e ngrohjes, mbeturinat e ngurta dhe të tjera, ku komunat kanë kompetencë.

Ndihma financiare deri në 50.000 dollarë amerikanë është e dedikuar për projekte nga komunat me seli në qytet që kanë më shumë se 25.000 banorë ose projekte që do të dorëzohen nga ana e qendrave për zhvillimin e rajoneve planifikuese. Komunat me seli në qytet ose fshat që kanë më pak se 25.000 banorë mund të konkurrojnë me projekte për ndihmë financiare deri në 20.000 dollarë. Mjetet e grantit janë të dedikuara për financimin e përgatitjes së dokumentacionit teknik, gjegjësisht për shërbimet e nevojshme të projekteve dhe shërbimet e lidhura konsultuese. Detyrimi i komunave dhe qendrave për zhvillimin e rajoneve planifikuese që do të marrin grant është të financojnë të paktën 20% të mjeteve të kërkuara nga granti, sipas kostove të vlerësuara për përgatitjen e dokumentacionit të paraparë teknik. Komunat apo qendrat e përzgjedhura për zhvillimin e rajoneve planifikuese do të nënshkruajnë marrëveshje përkatëse sipas të cilave do të ndërmarrin përgjegjësinë për realizimin e granteve. Qëllimi kryesor i kësaj thirrjeje është të sigurohen projekte me dokumentacion teknik të cilësisë së lartë që do të jetë adekuat me kërkesat e burimeve kryesore ndërkombëtare dhe vendase të financimit.

Fondi i Dokumentacionit Teknik është një instrument për mbështetje financiare dhe teknike në zbatimin e projekteve infrastrukturore në nivel lokal, ndërkomunal dhe rajonal dhe është krijuar me mbështetjen e projektit të UNDP-së "Forcimi i kapaciteteve komunale për zbatimin e projekteve", të financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA) dhe Byroja e Zhvillimit Rajonal. Projekti zbatohet në partneritet me Byronë e Zhvillimit Rajonal, Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale, BNJVL-në, komunat dhe qendrat për zhvillim rajonal dhe partnerë dhe palë të tjera të interesuara në nivel kombëtar dhe lokal. Kjo thirrje, e organizuar nga UNDP, është e dyta nga gjithsej tre thirrjet e planifikuara në kuadër të fazës së dytë aktuale të projektit (2022-2026). Thirrja e tretë do të zbatohet nga ana e Byrosë së Zhvillimit Rajonal.

Në fazën e parë u zbatua institucionalizimi dhe përmirësimi i Fondit të Dokumentacionit Teknik. Janë duke u zbatuar 13 grante (projekte komunale dhe rajonale). Gjithsej 20 komplete dokumentacioni teknik për gjithsej 47 projekte janë në fazën e përgatitjes. Për këto aktivitete janë kontraktuar nëntë trajnerë për të zbatuar zhvillimin e kapaciteteve të vendit të punës, të dedikuara për personelin relevant komunal. Gjithashtu mbahen sesione trajnimi për anti-korrupsion dhe integrimin e aspekteve gjinore në politikat kryesore për forcimin e kapaciteteve të institucioneve, projektet e të cilave financohen. Është planifikuar përgatitja e doracakëve, ndërsa në rrjedhë e sipër është edhe përgatitja e një analize funksionale për të lehtësuar transferimin e Fondit të Dokumentacionit Teknik nga UNDP-ja në Byronë e Zhvillimit të Barabartë.



## ОТВОРЕНИ МОЖНОСТИ ЗА ПРОДЛАБОЧУВАЊЕ НА СОРАБОТКАТА МЕЃУ ЗЕЛС И САЛАР

Тричлена делегација од САЛАР Интернационал, организација основана од Шведската асоцијација на локални и регионални власти (САЛАР), на 29 мај 2024 година беше во работна посета на ЗЕЛС. Тимот го предводеше Магнус Лилјстрем (Magnus Liljeström) советник во САЛАР Интернационал, специјалист за локална самоуправа, член на општински совет и извршен одбор и човек кој бил вклучен во реформите на здруженијата на локалните самоуправи во регионот од Западен Балкан и пошироко, како и Омар Јама (Omari Yama) и Лена Фалкон (Lena Falcon), советници во оваа организација. Целта на оваа посета беше проширување на соработката меѓу двете асоцијации. Поконкретно, претставниците од САЛАР Интернационал понудија можности за поддршка на ЗЕЛС во зајакнувањето на работата на телата и органите на Заедницата, преку пренесување на добри искуства и примери.

Разговорите ги водеше извршната директорка на ЗЕЛС, Душица Перишиќ и заменик-извршната директорка Ардита Дема Мехмети, како и претставнички од ЗЕЛС Тренинг центарот. Беше посочено дека во долгогодишното организациско искуство на ЗЕЛС, утврдени се солидни механизми кои досега покажале сериозно позитивни резултати во работењето на ЗЕЛС. Предизвиците со кои се соочува ЗЕЛС е состојбата на нејзините членки поради недоволното финансирање на префрлените надлежности и застојот на процесот на децентрализација на власта во земјата. Во дискусијата беа посочени повеќе области на можно воспоставување на идна соработка, особено околу надлежностите поврзани со спроведувањето на Зелената агенда, како едно од приоритетните залагања на ЗЕЛС и на единиците на локалната самоуправа во нашата земја, но и соработка во други области, што во следниот период ќе биде предмет на дополнителни разговори.

Соработката на ЗЕЛС со САЛАР започна минатата година кога ЗЕЛС стана партнер организација во спроведување на проектот „Одржливо управување со отпадот на локално ниво“ што се спроведува во шест пилот-општини од Пелагонискиот и од Југозападниот Регион: Битола, Прилеп, Новаци, Охрид, Кичево и Пласница, каде што се реализираат низа активности и е обезбедена поддршка во изработката на локалните акциски планови за управување со отпад.

## MUNDËSI TË HAPURA PËR THELLIMIN E BASHKËPUNIMIT MIDIS BNJVL-SË DHE SALAR-IT

Një delegacion prej tre anëtarësh nga SALAR International, organizatë e themeluar nga Asociacioni Suedez i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale (SALAR), më 29 maj 2024 ishte në një vizitë pune të BNJVL-së. Ekipin e udhëhoqi Magnus Liljestrom (Magnus Liljeström), këshilltar në SALAR International, specialist për vetëqeverisje lokale, anëtar i këshillit komunal dhe bordit ekzekutiv dhe një person që ka qenë i përfshirë në reformat e shoqatave të vetëqeverisjeve lokale në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe më gjerë, si dhe Omar Jama (Omari Yama) dhe Lena Falkon (Lena Falcon), këshilltarë në këtë organizatë. Qëllimi i kësaj vizite ishte zgjerimi i bashkëpunimit midis dy asociacioneve. Më konkretisht, përfaqësuesit e organizatës SALAR International ofruan mundësi për të mbështetur BNJVL-në në forcimin e punës së trupave dhe organeve të Bashkësisë, përmes bartjes së përvojave dhe praktikave të mira.

Bisedimet i udhëhoqën drejtoresha ekzekutive e BNJVL-së, Dusica Perishiq dhe zëvendës-drejtoresha ekzekutive Ardita Dema Mehmeti, si dhe përfaqësuese nga Qendra e Trajnimeve të BNJVL-së. U theksua se në përvojën shumëvjeçare organizative të BNJVL-së u krijuan mekanizma solidë që deri më tani kanë treguar rezultate serioze pozitive në punën e BNJVL-së. Sfidat me të cilat ballafaqohet BNJVL-ja është gjendja e anëtareve të saja në sferën e financimit të pamjaftueshëm të kompetencave të bartura dhe stagnimi i procesit të decentralizimit të pushtetit në vend. Në diskutim u theksuan më shumë sfera të vendosjes së mundshme së një bashkëpunimi të ardhshëm, veçanërisht në sferën e kompetencave të lidhura me zbatimin e Agjendës së Gjelbër, si një nga zotimet prioritare të BNJVL-së dhe të njësive të vetëqeverisjes lokale në vendin tonë, por edhe në sfera të tjera që në periudhën e ardhshme do të jenë objekt i bisedimeve plotësuese.

Bashkëpunimi i BNJVL-së me SALAR-in filloi vitin e kaluar kur BNJVL-ja u bë organizatë partnere në realizimin e projektit “Menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave në nivel lokal”, i cili zbatohet në gjashtë pilot komuna nga rajoni i Pellagonisë dhe ai jugperëndimor: Manastiri, Prilepi, Novaci, Ohri, Kërçova dhe Plasnica, ku realizohen një sërë aktivitetesh dhe ofrohet mbështetje në zhvillimin e planeve aksionare lokale për menaxhimin e mbeturinave.

ЗАЕДНИЦА НА ЕДИНИЦИТЕ НА ЛОКАЛНАТА САМОУПРАВА
НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

BASHKËSIA E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE TË
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



**КОНТАКТ ИНФОРМАЦИИ**

тел. +389 (0)2 30 99 033 | факс: +389 (0)2 30 61 994
ул. "Копенхагенска" бр. 5, п. фах 32, 1000 Скопје, Република Северна Македонија
contact@zels.org.mk | www.zels.org.mk

**INFORMACIONE PËR KONTAKT:**

tel. +389 (0)2 30 99 033 | faks: +389 (0)2 30 61 994
rr. "Kopenhagenska" nr. 5, F.P. 32, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut
contact@zels.org.mk | www.zels.org.mk